



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 439

Datë: 01.11.2018

PROCESVERBAL

i mbledhjes së X-të (e dhjetë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI I DITËS

1. Emërimi i tre anëtarëve të Komitetit për Barazi Gjinore
2. Emërimi i tre anëtarëve të Komisionit për Banesat e 32 Familjeve në Lagjen "Mirëdita" në Malishevë
3. Debat rreth raporteve të bashkëpunimit të Qeverisë Komunale dhe Kuvendit të Komunës
4. Shqyrtimi i Raportit i 6-mujor i punës për vitin 2018 i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
5. Shqyrtimi i raportit të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projeket-Buxhetit për vitin 2019
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa, dhe Gjoha Komunale për vitin 2019
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për Periudhën Janar-Shtator 2018.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/333 datë: 10.09.2018 e parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/334 datë: 10.09.2018 e parashtrua nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës
11. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/322 datë: 30.08.2018 e parashtruar nga Mehemet Krasniqi nga fshati Tërpezë.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.09/427 datë: 18.08.2018 të parashtruar nga Osman Robaj nga fshati Astrazup për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore
13. Të ndryshme

Mbledhja mbahet me datë 26.09.2018 dhe filloi në ora 10:20. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 18 asambleistë, Kryetari, Nënkryetari, drejtorë komunalë, përfaqësuesit e MLT-së, përfaqësuesi i KKZ-së, media dhe qytetarë.

Rrahim Morina: Përshëndetje për Kryetarin, naëtarët e Kuvendit dhe ju të pranishëm! E hapi mbledhjen e X-të të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës. Kam një propozim që sot të mos ketë debat jashtë rendit të ditës sepse pikat që do të diskutohen sot janë shumë voluminoze dhe do të ketë debate të zgjatura. Kërkoj deklarinimin e grupeve politike që a po pajtoheni me këtë propozim.

Sylë Dukolli: Ne pajtohem që të mos ketë debat jashtë rendit të ditës.

Alban Mazreku: Edhe ne pajtohem me propozimin e juaj Kryesues.

Alban Krasniqi: Pajtohem edhe ne.

Rrahim Morina: Mirë. Atëherë e hapi debatin rreth rendit të ditës. Urdhëroni kush e do fjalën?

Luan Kryeziu: Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket rendit të ditës dua të diskutoj me disa çështje që lidhen me të. Përpilimi i rendit të ditës nuk është mirë dhe drejt sepse në çdo mbledhje të rregulltë duhet si pikë e 1-rë e rendit të ditës të jetë edhe procesverbali i mbledhjes së kaluar. Në këtë rend dite s'ka procesverbal, pse nuk është përfshirë? Tjetër është mosrradhitja e pikave të rendit të ditës sipas peshës dhe rëndësisë së tyre. Ka pika që nuk janë aq të rëndësishme e që janë në fillim krahasuar me ato të tjerat që janë më të rëndësishme e janë të rradhitura nga fundi. Te emërimi i disa anëtarëve është dashur të të ceket edhe vendimi, se nëse vetëm emrohen pa u marrë vendim nga ana e Asamblesë nuk e di çfarë efekti juridik mund të kenë.

Rrahim Morina: Sa i përket procesverbalit po e jap arsyeshmërinë pse nuk është sjellë. Ka edhe procesverbale tjera jo vetëm të mbledhjes së fundit sepse një vendim që është marrur nga Kuvendi nuk po zbatohet. Të zyrtaret kanë mbetur pa zyre pune dhe pa kushte pune, prandaj nuk kanë mundësi që ta kryejnë punën e vet. Është mirë që ekzekutivi ta zgjidhin këtë problem sa më shpejtë dhe të zbatojnë vendimin e Kuvendit. Sa i përket rënditjes së pikave në rendin e ditës është kjo. Pikat që kanë mbetur pa u shqyrtuar nga mbledhja e kaluar renditën si të parat, pastaj pikat e reja shkojnë poshtë tyre.

Kryetari – Ragip Begaj: Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm! Sqarimet që dha Rrahimi nuk qënderojnë ashtu. E di që këto zyrtaret nuk kanë zyre, por ne ju kemi gjetur zyren dhe jemi duke u munduar që t'ju krijojmë kushte. Ka ndodhur shumë herë nëpër mbledhje kur procesverbalet nuk kanë mundur të kryhen. Ka mundur të ndodh edhe kjo. Këto mund të vijnë në zyren time që të punojnë deri sa t'ju ofrojmë mundësitë për punë. Ky nuk është arsyetim që s'kanë pasur zyre dhe s'kanë mund të kryejnë procesverbalin. Kryesues, është hera e parë që kryesuesi e dorëzon rendin e ditës pa konsultim me Kryetarin. Kjo është shkelje ligjore. Kryesuesi është i obliguar që rendin e ditës që të harmonizojmë pikat e

rendit të ditës e pastaj ne e përcjellim për Kuvend. Kryesuesi nuk bënë me dorëzu rendin e ditës pa u konsultuar me Kryetarin.

Rrahim Morina: Kjo është e vërtetë Kryetar, por kërkesat i ka sjellur Këshilltari Juridik në KPF dhe unë e kam marrë si punë të kryer rendin e ditës. E di që e kam obligim që për rendin e ditës të konsultohemi, edhe ligji e thotë ashtu. Kërkoj falje për këtë rast!

Mbase s'ka më debat për rendin e ditës, atëherë kush është për?

Për: unanimitisht (25)

Kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Emërimi i tre anëtarëve të Komitetit për Barazi Gjinore. Të tre subjektet politike i kanë sjellë emrat, janë votuar si dhe është votuar Zyrtarja për Barazi Gjinore. Vendet e zbrazuara kanë mbetur për 1 anëtar nga shoqëria civile, dhe 2 përfaqësues nga NISMA. Kërkoj që t'i propozoni këta emra.

Filloretë Bytyqi: Përshendetje për të gjithë! Ne NISMA propozojmë për këtë Komitet Sadije Krasniqi dhe Astrit Sertolli.

Sot jam krenare sepse vajzat e fshatit Kërvasari kanë fituar kampionatin në futboll të vogël. Kryetar, kërkoj nga ju që të ndërtoni një palestër të sportit në fshatin tonë sepse ato e meritojnë.

Rrahim Morina: Kush është për që Sadije Krasniqi dhe Astrit Sertolli të jenë anëtarë në Komitetin për Barazi Gjinore?

Për: 25, unanimitisht

Me këtë votim Sadije Krasniqi dhe Astrit Sertolli janë anëtarë të këtij Komiteti.

A keni ndonjë propozim për anëtarin nga shoqëria civile?

Alban Krasniqi: Shoqëria civile i përfshinë gazetarët, intelektualët që kanë reputacion në komunitet, OJQ etj. Bazuar në rëndësinë e këtij Komiteti propozoj një zonjë që prej pasluftës ka qenë e angazhuar në shoqërinë civile dhe është marrë me çështjet e grave dhe aktualisht është mësimmshënese në Bellanicë, fjala është për Zade Zogaj dhe ne e propozojmë për anëtare të këtij Komiteti.

Rrahim Morina: Nëse s'ka propozime tjera atëherë kush është për që Zade Zogaj të jetë anëtare e Komitetit për Barazi Gjinore?

Për: 24

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me këtë votim Zade Zogaj bëhet anëtare e këtij Komiteti.

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Emërimi i tre anëtarëve të Komisionit për Banesat e 32 Familjeve në Lagjen "Mirëdita" në Malishevë. Unë kam marrë një propozim me shkrim nga këto 32 familje dhe fjala është për Cen Deskun. Kanë mbetur 2 vende të lira edhe për dy të propozuarit e Kryetarit, prandaj Kryetar fjalën e keni.

Kryetari – Ragip Begaj: Këtë temë e kemi trajtuar edhe më heret dhe është shumë komplekse sepse ato banese edhe janë stërshitur edhe pse pronarë të tokës nuk janë ata banorë. Pronar i asaj toke është komuna. Materilin e ka financuar një OSBE mbas luftës dhe i ka ndërtuar ato banesa. Ata kanë dashur që ato banesa t'i bëjnë të vetat por sido që të jetë ky komitet le të punojë mbi baza ligjore.

Unë propozoj që anëtarë në atë komitet të jenë Muharrem Morina dhe Fadil Shala të dy janë juristë.

Rrahim Morina: Atëherë i hedhi në votim të tre të propozuarit, Cen Deskun, Muharrem Morinën dhe Fadil Shalën si aëtarë të Komisionit për Banesat e 32 Familjeve në Lagjen “Mirëdita” në Malishevë. Kush është për?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 8

Me këtë votim këta të propozuar janë anëtarë të Komisionit për Banesat e 32 Familjeve në Lagjen “Mirëdita” në Malishevë. Me këtë edhe kompletohet ky komision. Kalojmë në pikën e 3-të të rendit të ditës: Debat rreth raporteve të bashkëpunimit të Qeverisë Komunale dhe Kuvendit të Komunës. Kjo është kërkesë e grupit të PDK-së dhe fjalën e ka Alban Mazreku si propozues i kësaj pike.

Alban Mazreku: Përshëndetje për të gjithë! ne në vazhden e kërkesave që ju kemi drejtuar Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale, pothuajse në shumicën prej tyre nuk kemi marrur përgjigje. Një ndër kërkesat tona ka qenë edhe raportimi i qeverisë komunale për të punësuarit me kontratë mbi vepër si dhe nga Drejtoria e Financave sa është kostoja për pagesat e tyre. Ne kemi marrur vetëm një përgjigje nga drejtori Dibran Kastrati për ispetimin e shkollës fillore “Ibrahim Mazreku”. Inspektoriat ka konstatuar që aty gjendja shumë e mjerueshme dhe raportin e kanë bërë në mënyrë korrekte. Për këtë është njoftuar edhe Kryetari i Komunës, Nënkryetari dhe drejtori i Arsimit. Një intervenim është bërë në këtë shkollë por përsëri gjendja është shumë e keqe.

Te zgjerimi i shtratit të lumit “Mirusha” e kemi mirtuar shpronësimin e pronave, por shpronësimi ende nuk ka filluar.

Kemi miratuar edhe çështjen e parkingut përgjatë rrugës “Ibrahim Mazreku”, por ende ai vendim nuk po zbatohet.

Alban Krasniqi: Ne e kemi diskutuar këtë çështje edhe në KPF i ftoj edhe anëtarët e NISMA që të marrin pjesë në komitet. Është mënyra dhe qasja e qeverisë kjo që na bënë neve të diskutojmë këtu për mosbashkëpunim në raport me KPF-në. Nëse Kryetari kërkon që pikat e rendit të ditës të vijnë këtu, ai duhet të fillojë dhe ta respektojë këtë komitet e që është ndër më të rëndësishëm i cili është duke u lënë anash në kuptimin përgjegjësi që ka qeverisja në dhënien e informacioneve. Kjo fushë duhet të rregullohet këtë duhet të dinë Kryetari dhe drejtorët. Kryetari dhe ekzekutivi nuk janë vetëm përfaqësues të NISMA por përfaqësues të gjithë qytetarëve të K. së Malishevës dhe janë të obliguar që t’ju përgjigjen institucioneve që dalin prej Kuvendit Komunal.

Unë kam me dhjetëra kërkesa të drejtuar qeverisë e sidomos Valonit në lidhje me buxhetin dhe investimet. Ai herë thotë t’i jap përgjigjet e herë nuk përgjigjet fare. Sjlleja e cila ma përkujton pushtetin e Serbisë, besa edhe nuk ka pasur çfarë bëni ju Valon si servil i pushtetit. Në rrethana normale ju shumica drejtorëve nuk i keni plotësuar kushtet as për punë administrative, e jeni bërë drejtorë për motive politike. Por, mos krijoni vetëbesim se mund të bëni çfarë të doni, por keni shumë përgjegjësi. Ju e dini sa kërkesa ju kam drejtuar juve dhe sa prej jush më jeni përgjigjur dhe pse ju tjerët nuk jeni përgjigjur. Qeveria nuk komunikohet lehtësisht në marrjen e

informacioneve që mund të jenë të mundëshme edhe pa bërë kërkesë me shkrim. Kë që bëni ju s'ka lidhje me sjellje civilizuese e as njerëzore.

Bëjuni transparentë dhe jepni llograi sepse është në të mirën e juaj sepse është përgjegjësi për ligjin, qytetarët dhe mbi të gjitha për luftën e UÇK-së që të kemi një shoqëri të mbarë dhe institucione që u përgjigjen qytetarëve.

Sylë Dukolli: Përshëndetje për të gjithë! Me vëmendje i dëgjova parafolësit dhe po i drejtohem Alban Mazrekut. E pash raportin e Inspektorit për shkollën fillore "Ibrahim Mazreku" dhe pres Drejtorin e Arsimit dhe ajo e Inspektoriatit që të marrin masat për gjendjen që është në atë shkollë e të përmirësohet sa më shpejtë sepse është në pyetje shëndeti i fëmijëve tanë. Sa i përket KPF-së i përgjigjem Alban Krasniqit, ne jemi ende në pritje të kuotës. Edhe neve na dhemb pse nuk jemi pjesë e KPF-së. Shpresoj që së shpejti të jem pjesë e atij komiteti dhe do të bashkëpunojmë dhe të arrijmë ma të mirën e mundshme. Ndoshta jam i vetmi që kam kërkuar që të bëhet diçka në atë drejtim. Sa i përket bashkëpunimit Kuvend dhe ekzekutiv, Kryetari Begaj kurrë nuk sillet vrazhdë dhe nuk është i vështirë për të komunikuar sikurse që kjo Komunë ka pasur më heret. Ne këta drejtorë i kemi zgjedhur pa provojë sepse nuk e kanë pas zehen e hajnit dhe nuk kanë pasur asnjë. Unë kërkoj që ata të jenë transparentë dhe çdo projekt që kalon nëpër Kuvend nuk është që të fshihet dhe jepuni grupeve politike të gjitha informatat që kërkojnë sepse e heqni nga vetja përgjegjësinë dhe jam për bashkëpunim të plotë.

Kastriot Berisha: Përshëndetje për të gjithë! Pajtohem me atë që tha Sylë dhe fjalë të mira dha këtu, por vepra s'ka kërkuar.

Ju bëj thirrje të gjithë asambleistëve të NISMA që të bëni presion mbi qeverinë që të bashkëpunojmë më shumë me ne. Si të sjellin raport kur nuk dinë drejtorët e veçanarisht po i drejtohem atij të Bujqësisë që është analfabetik do e shohim te pika e Bujqësisë se çfarë raporti ka sjellë.

A e din pse sillen kështu këta drejtorë, sepse lideri i tyre për t'i mbulluar marrëzitë e mëhershme sot ju thotë atë mos e prekni, le të bëjnë çka të dojë sepse është prej Bellanice. Drejtor, nuk do të sillesh këtu si kauboj, sepse këtu kemi ardhur me votën e qytetarëve.

Kryetar, është për të ardhur keq që ndahen 150 subvencione dhe askush të mos e di se kujt po ja jep. Ne ju kemi drejtuar me disa kërkesa për këto çështje.

Sa i përket shkollës "Ibrahim Mazreku" në oborrin e saj derdhet kamioni me 2000 kg për gjimnazin "Hamdi Berisha" e në prani të nxënësve shkarkohet. Kjo askund në botë nuk ndodhë që të shkarkohet kamioni në prani të nxënësve. Kryetar, çka nëse e nxen ndodnjë fëmijë gjatë shkarkimit?

Rrahim Morina: Ju lutem që të diskutojmë vetëm për pikën e rendit të ditës, mos të dalim jashtë teme.

Valon Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket kësaj pike shihet qartë që në këta muajt e fundit që ka pasur ngecje në bashkëpunim. Kjo ngecje ndodh sepse nuk po respektohen kompetentët dhe në këtë rast duhet edhe Kuvendi të respektohet sepse ka marrë shumicën. Ka raste kur Kuvendi ka marr disa vendime e ekzekutivi nuk po i respekton siç është rasti i Sallës së Sporteve në Drenoc. Ne duhet të arrijmë një unitet sepse për këtë gjendje janë humbës qytetarët e Malishevës.

Sadije Krasniqi: Përshendetje për ju të pranishëm! Unë dua të shpreh një shqetësim timin lidhur me gjuhën denigruese që po përdoret këtu në Kuvend. Këto diskutime nuk i bëjnë nder askujt. Diskutimet duhet të drejtohen në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve tanë dhe jo të keqpërdoret foltorja këtu e ata të dëgjojnë fjalë nga më të ndryshme këtu.

Kryetari Begaj është një bashkëpunor shumë i mirë, gjithëmonë dera e tij është e hapur për çfarëdo punë qoftë ajo dhe nuk sillet në mënyrë injorante me askënd.

Dëgjova shumë vërejtje për drejtorët, por unë besoj që ata janë duke kryer detyrën në mënyrën më të mirë të mundshme. Besoj që me kohe edhe aty ku ka zbrazëti duhet të plotësohen dhe raportet tyre kanë me qenë në mënyrën që ne e kërkojmë.

Rrahim Morina: Ingjizim direkt të mbledhjes nuk paska. Të presim pak deri sa të rregullohet.

Luan Kryeziu: Sa i përket kësaj pike, mendoj që debati i Kuvendit karshi Qeverisë është i rregulluar me Ligjin mbi Qeverisjen Lokale, Statuti i Komunës dhe rregullore të ndryshme që janë aprovuar nga ky Kuvend. Ne i dimë kompetencat tona si anëtarë të Kuvendit sipas nenit 39 të drejtat, detyrat e anëtarëve Asamblesë dhe është mirë që t'i respektojmë ato dhe mos të dalim jashtë kompetencave tona. Është mirë që të mos përzihemi në kompetencat e qeverisë. Vendimet që merren me shumicën absolute të votave të anëtarëve të Asamblesë, dhe në momentin që mirret nga shumica atëherë edhe nga Qeveria komunale janë të respektueshme dhe të ekzekutueshme. Në qoftëse ndonjë vendim nuk ekzekutohet atëherë janë instucionet tjera, gjykata ku mundem t'ju drejtohem.

Në qoftë se ndonjë anëtar i këtij Kuvendi mendon që ky bashkëpunim është në realizimin e interesave të tij personale duke u thirrur në interesa të përgjithëshme të shoqërisë, mendoj që kjo është kamuflim dhe është tradhëti ndaj qytetarëve.

Nebih Bibaj: Përshendetje për të gjithë! Luan, vendimet e Kuvendit që nuk i ka zbatuar qeveria janë të shumta siç është Qendra e Sporteve në Drenoc, Parkingu në rrugën "Rilindja Kombëtare" e etj. Nëse flasim për një bashkëpunim Qeveri-Kuvend, nuk ka ka. Kuvendi nuk ka ndërhy asnjëherë në punët e qeverisë. Qveria nuk ka zbatuar vendimet e Kuvendit. Kjo është!

Luan Kryeziu: Thash: në qoftëse ai vendim që është marrë nga shumica e anëtarëve të Asamblesë dhe nuk zbatohet nga ana e qeverisë, atëherë mundemi të aplikojmë metoda tjera, një ndër to është gjykata.

Alban Krasniqi: Nuk është e rregulluar çdo gjë në shoqëritë e zhvilluara me ligje dhe procedura, por është edhe me aktivizëm qytetar, përfaqësim politik, ndërgjegjie, vetëdije dhe këto nuk mundesh t'i gjesësh në ligj. Tendenca që çdo gjë çojë në gjykatë, mendoj që është ikje e përgjegjësisë kryesore që na ka dhënë qytetari për ta përfaqësuar. Kjo qasje që shko tek gjykata është tipike si në ish-sistem ku s'ka pas demokraçi po veç ligji dhe rendi. Kur vjen puna që gjykata më jep të drejtë mua, nëse ti bashkë me të tjerët ke moral duhet të japësh dorëheqje, edhe Kryetari duhet të jep dorëheqje. Por, kjo nuk ndodh. Ju po e mbronin një të keqe duke thënë: leje këtë, shko në gjykatë. Kur puna mbërrinë tek gjykata çështjet këtu do të marrin fund. Ne po flasim që gjërat t'i përmirësojmë para se të shkojmë tek gjykata.

Sa i përketë Parkingut në rrugën "Ibrahim Mazreku" vendimi ka ardh nga Ministria ashtu siç është nuk po zbatohet. Kjo tregon se si e trajtoni ju komunën, e trajtoni si plaçkë. Kjo i bjen se çka na konvenojmë e zbatojmë e çka jo nuk e zbatojmë.

Rrahim Morina: Po flas si anëtar i Asamblesë dhe është fakt i pamohueshëm që gjendja e bashkëpunimit nuk është e knaqëshme. Mendoj që kjo duhet të tejkalohet patjetër. Kuvendi dhe Kryetari janë dy organe qeverisëse në komunë që i kanë detyrat dhe përgjegjësitë e veta. Ne nuk po mund të pajtohemi me një realitet që është krijuar në mes Kuvendit dhe Qeverisë. E di që pushtetit për t'i shkuar punët mirë duhet ta ketë shumicën në Kuvend, por duhet të pajtohet edhe me shumicën që është tani në Kuvend. Çdo vendim i Kuvendit është i plotëfuqishëm dhe duhet të zbatohet.

E lus Kryetarin që të tejkalojë këtë situatë e cila është formuar që nga KPF-ja që nuk është formuar në bazë të ligjit dhe rregulloreve sipas pushtetit. Kërkesat që ju drejtoj drejtorëve si Kryesues i Kuvendit, shumicën e përgjigjieve nuk e marrë. Kjo gjendje e mosbashkpunimit nuk është në favor të qytetarëve po as të qeverisë komunale. Është mirë që të gjithë të japim kontributin tonë dhe kjo situatë të tejkalohet dhe raportet e bashkëpunimit të përirësohen.

Kryetari- Ragip Begaj: Sa i përketë KPF-së ju e dini mirë që ai komitet është formuar me shkelje ligjore për këtë ka ardhur edhe vlersimi nga MAPL. Unë kam kërkuar plotësimin e asaj zbrazëtire.

Këtu nuk jam i NISMA, këtu jam Kryetari i Komunës dhe do të përpiqem që të sillem si i tillë dhe me të gjithë sillem njësoj të cilit do subjekt të jenë.

Normale janë ato përplasjet pozitive-opozitive. Ka raste kur opozita i ndihmon pozitës që të çelë sytë në disa raste sepse është e pamundur që të kryhet të gjitha punët. U dhanë këtu disa vërejtje ligjore. Drejtorët më përgjigjen mua dhe ligjërisht Kryesuesi duhet që t'më drejtohet mua. Unë ju kam thënë drejtorëve që t'ju përgjigjen të gjitha kërkesave. Nuk është që ata nuk kanë dashur t'ju përgjigjen por nuk kemi mundur që t'i përcjellim për shkak të angazhimeve të shumë që kemi dhe në paundësi që t'i kryejmë të gjitha detyrat jemi vonuar edhe në përgjigjet e juaja. Unë kam përgjegjësi para jush, jo drejtorët. Për çdo cent të Komunës së Malishevës që është shpenzuar keni të drejtë të informoheni seps çdo gjë është publike. Edhe për çdo subvencion që është ndarë keni të drejtë të informoheni sepse janë publike. A janë ndarë mirë a keq nuk e di dhe është normale nëse ka gabime. Të gjitha këto i keni të pasqyruara në faqen e Komunës.

Alban si shumë po e përmend ish-sistemin jugosllav. Në atë kohë t'i ke qenë i ri dhe nuk e din se si ka funksionuar ajo kohë ka shkuar. Hajde të punojmë për sot, edhe nëse është gabuar dje, hajde ta përmirësojmë në ardhmen!

Kastriot, hajdeni të përpiqemi e ta këshillojmë njëri-tjetrit. Ka pasur vërejtje për gjendjen në shkollën "Ibrahim Mazreku" prandaj kemi filluar ta renvojmë e që është gati në përfundim. Ne kemi bërë shumë punë sa i përketë infrastrukturës së shkollave dhe për shkollat në përgjithësi. Në krahasim me të kalurën dhe disa vende ne jemi shumë mire me gjendjen në arsim. Bashkëpunimi i juaj me mua, unë konsideroj që është i mirë. Unë jam i gatëshëm për bashkëpunim të mirëfilltë. Ju e dini që keni bërë shkelje në KPF, ju e dini që sot ka bërë shkelje Kryesuesi që ka thirrur mbledhje pa u konsultuar me mua, mirëpo unë ju thash që po ja fali. Hajde t'i përmirësojmë këto shkelje, unë jam i gatshëm. Nuk bien vendimet veç për inati. Vendimet merren me një arsyeshmëri e që është në shërbim të qytetarëve. Sa i përketë vendimit për parkingun në rrugën "Ibrahim Mazreku", ajo rrugë nuk i plotëson kushtet për parking. Rruga

është shumë e ngushte dhe nuk ka kushte ligjore për parking për këtë kemi kërkuar rivlerësim të atij vendimi.

Kastriot Berisha: Kryetari tha që ka kërkuar nga Komiteti për Bujqësi që t'i bëjnë politikat për zhvillimin e bujqësisë. Mirëpo Kryetar unë si Kryesues i atij komiteti nuk kam marrur një kërkesë të tillë. Ne kemi kërkuar me anë të një kërkesë Planin e Punës të Drejtorisë së Bujqësisë por nuk kemi marrur përgjigje. Është mandati i dytë që drejtori asnjëherë nuk ka marrur pjesë në asnjë mbledhje të këtij komiteti. Atëherë si t'i punojmë politikat e zhvillimit të bujqësisë bashkarisht? Kjo është neglizhencë totale e drejtorit.

Alban Krasniqi: E para, për tranzitin është projekti i cili tregon për qasjen reale të kësaj qeverisje në raport me qytetarët. Me këtë e kam të qartë se këta nuk janë të intersuar për t'ja lehtësuar jetën qytetarëve por veç me pru diçka kinëse po inestojmë pa u konsultuar me qytetarët sepse askush nuk e ka parë projektin. Kam një pyetje a është PSHK-ja valide? Nëse PSHK-ja nuk e ka marrë dritën jeshile nga Ministria çdo vendim nga kalon traseja paraprakisht vendimi duhet me u marrë këtu sepse është tokë e Komunës. Kryetar ke bërë shkelje të rëndë ligjore.

Kryetar në rrugën "Ibrahim Mazreku" parkingu është nga ora 19:00 e mbrëmjes deri në ora 07:00 e mëngjesit dhe gjatë ditës është një parking i përkohshëm deri në 15 min kjo asgjë nuk e pengon komunikacion deri sa të gjendet zgjidhja mbase po kërkon ju.

Alban Mazreku: Kryetar falemnderit për gadishmërinë e juaj për delarimin për puntorët me kontratë mbi vepër shperesoj që në seancën tjetër do t'na informosh për këtë çështje. Sa i përket gjendjes në shkollën fillore "Ibrahim Mazreku" çështjen e kam ngritur në muajin mars. Inspektoritati ka vizituar shkollën në muajin prill dhe ka konsultuar gjendjen të cilën unë e kam paraqitur. Drejtorja e Arsimit thuhet që realisht i ka marrë ato masa për atë gjendje të keqe por, në prkatikë kushtet higjenike edhe sot janë në kushte shumë të këqija. Unë mendoj që Drejtorja e Arsimit është dashur të merr masa ndaj menaxhmentit të shkollës, nëse jo Drejtorja e Arsimit, Kryetar duhet me marr masa ti dhe shkarkoj nga detyra drejtorin, zëvendës drejtorin dhe pedagogun e shkollës sepse përndryshe unë do t'i ndal fëmijët e mi nga shkolla dhe do t'ju bëjë ftesë të gjithë prindërve të tjerë që t'i ndalim fëmijët nga shkolla deri në përmirësimin e kushteve. Me atë vendim të Inspektoriatit ajo shkollë është dashur të mbyllet.

Luan Kryeziu: Këtu u përmend çështja e bashkëpunimit për tranzitin. Kjo më tepër është kompetencë e pushtetit qendror dhe jo e pushtetit lokal që të intervenojnë. Ne duhet të jemi të kënaqur me këtë projekt madheshtor sepse është në interesin e qytetarëve.

Halil Morina: Ne këtu po diskutojmë për raportin në mes të Kuvendit dhe Qeverisë Komunale. Ne të gjithë po e shohim që nuk ka një funksionim të duhur në mes ekzekutivit dhe legjislativit. Pse nuk është ky bashkëpunim ashtu siç duhet të ishte?! Cilat janë shkaqet e këtij mosbashkëpunimi? Si t'i eliminojmë këto shkaqe që të funksionojnë si duhet edhe ekzekutivi edhe legjislativi?

Mendoj që janë dy faktorë kyç që e kanë shkaktuar këtë gjendje. E para, kur është konstituuar ky Kuvend, bashkimi i partive opozitare është krijuar me një qëllim që të bëhet një bllok, të kapet një mekanizëm në dorë dhe përmes tij në një farë mënyre të sabotohet qeveria komunale. Kjo ka reflektuar në anën e kundër si reaksion që qeveria komunale përpiket që të mos i respektojnë disa

vendime të tyre. Ky është shkaku kryesor. Çfarë mund të bëjmë që ta eliminojmë këtë shkak? Qytetarët e Malishevës para se t'na votojnë kanë qenë të bindur që ne mund të bëjmë diçka për ta në momentin që do të jemi përfaqësues të tyre në Kuvend. A kemi ne të drejtë që mekanizmin që na kanë dhënë qytetarët ta përdorim për inate personale e politike? Kjo shkon në dëm të qytetarëve. Ne duhet urgjentisht për hir të atyre që na kanë besuar votën me i lënë këto inate dhe të përpiqemi që të jemi më të arsyeshëm, objektiv për hir të interesave të tyre. Arsyeja tjetër që ne nuk e kemi kuptuar qartë se cili është roli i Kryetarit të Komuës dhe roli i Kuvendit. Këtu dikush ka tendenca që KPF me bë më të fuqishme se Kryetarin e Komunës sepse gjithëçka duhet të kalojë përmes Komitetit. Atëherë çka është Kryetari i Komunës? Nuk e kemi zgjedhur ne si Kuvend Kryetarin e Komunës dhe as nuk mund ta shkarkojmë ne. Kryetari i Komunës është zgjedhur direkt prej votës së qytetarëve dhe ky u jep llogari direkt qytetarëve. Ne nuk mund ta detyrojmë veç që i kemi 16 vota që me i marrë vendimet. Prandaj ne duhet ta kuptojmë qartë rolin e Kuvendit se deri ku janë kompetencat e Kuvendit në raport me Kryetarin e Komunës kur ne e kuptojmë mirë këtë çështje atëherë e kuptojmë se çka është përgjegjësi e jona si Kuvend dhe Kryetari e di se çka është përgjegjësi e veta si qeveri.

Rrahim Morina: Kalojmë në pikën e 4-ërt të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit i 6-mujor i punës për vitin 2018 i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural. Urdhëro drejtor e keni fjalën!

Murat Hoxha: Përshendetje për të gjithë! Drejtoria e Bujqësisë për këtë periudhë përveç aktiviteteve që ka pasur ka kryer edhe disa projekte. Stafi i kësaj drejtorie ka qenë i anazhuar në aplikimin e fermerëve. Ky aplikim ka filluar nga data 15 shkurt deri më 31 mars dhe është shtyer deri më 13 prill. Gjatë kësaj periudhe kanë aplikuar rreth 1200 fermerë. Si projekte të Bujqësisë që kanë përfunduar deri më tani janë:

- ngritjes së serave me sipërfaqe prej 100m². Shuma totale për këtë projekt ka qenë 28,875.00€.
- përkrahja e fermerëve me makina mjelëse, përfitues ishin 70 fermerë me bashkë finacim 70 nga ne dhe 30% nga fermerët i cili ka kushtuar 11,830.00€
- paisja me motokultivatorë; janë shpërndarë 150 motokultivatorë me bashkëfinacim 70 me 30, projekt i cili ka përfunduar
- projekti i bletarisë, pritët që të hënë të bëhet shpërndarja për përkrahjen e bletarisë
- hapja e bunarit për fermerin Gentiana Mustafa në fshatin Plloqicë dhe është në procedura të prokurimit
- vaksinimi i qenëve shtëpiak në bashkëpunim me Agjensionin Ushqimit dhe të Veterinarisë në vlerë prej 3,000€
- vaksinimi i deleve dhe i dhive në bashkëpunim me Agjensionin e Ushqimit dhe Veterinarisë në K. e Malishevës e që janë vaksinuar 15,000€ sosh nga to

Gjatë muajit qershor Drejtoria e Bujqësisë ka formuar Shtabin Komunal për Korrje-Fshirje ku janë korrur 3780 hektar.

Spektori i Pylltarisë sivjet ka filluar pastrimin dhe rrallimin e zonave pyjore në zonën kadastrale Lladroc, Tërpezë, Fashati i Ri dhe Berishë, projekt në bashkëpunim me Agjensionin Pyjor dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Malishevës. Të punësuar nga ky projekt me kontrat 6-Mujshe janë 40 persona. Projektet tjera janë në procedura të prokurimit dhe do të njoftoheni me kohë edhe me procedura tjera. Falemnderit!

Kastriot Berisha: Kryetar, unë nuk e di se çka lexoi drejtori, ne e kemi një raport tjetër që ai na dërguar neve. Nuk e di ku po i marrin këto raporte dhe është e turpshme që raporti është prej tri fletësh për një punë 6-mujore. Ju asamblesistë të NISMA a është turp për ju nëse ju e përkrahni një raport të tillë?! A e dini pse është një raport i tillë? Sepse nuk dinë se çfarë të shkruajnë sepse nuk punojnë. Kjo është e turpshme për qytetarët e Malishevës, “mos ju qitni hi syve”. Komiteti për Bujqësi në mbledhjen e mbajtur me dt: 29.08.2018 me vota unanime e hodhi poshtë raportin 6-mujor të punës për vitin 2018 të Drejtorisë së Bujqësisë. Arsyeja ishte sepse raporti është analfabetik dhe s’ka lidhje me një raport çfarë duhet të ishte. Aty ka mospërputhje marramendëse të shifrave në projektet që i ka rënditur drejtori prej 1-5. Nëse e bëjmë një kalgulim të thjeshtë ja jep shumën e relaizuar të projekteve 116, 237.00€ pa hequr 30% që ë ka investuar qytetari. Ndërsa në raport shifra e këtyre projekteve është në vlerë prej 223,237.00€. Ku është problemi këtu, pse është një diferencë kaq e madhe?! Ku i keni janë këto para? Te raporti i Drejtorisë së Financave faqe 21 thuhet: Drejtoria e Bujqësisë ka shpenzuar për periudhën Janar- Qershor për vitin 2018, 7,712.36€. Ku i morën paratë tjera kjo drejtori? Qytetarë të nderuar të K. së Malishevës mos ankoheni që nuk është bërë përzgjedhja e duhur për përfitimin e subvencioneve, sepse në këtë komunë meritoret kurrë nuk përfitojnë! Nëse kanë përfutuar meritotërt është dashur të sillen listat e aplikuese dhe të përfitueseve që kemi kërkuar që sa e sa kohë. Ne nuk kemi asnjë dokument se kush ka aplikuar e kush ka përfutuar. Ne Komiteti i Bujqësisë ju kemi drejtuar me disa rekomandime që ju kemi sjellur për raportin e Bujqësië të cilin e keni ju asambleistë. Ne kërkojmë që këto rekomandime që të obligohet drejtori i Bujqësisë që t’ju përgjigjet këtyre rekomandimeve.

Alban Krasniqi: Kastrioti i tha të gjitha pothuajse, i përmendi shifrat ku ka gabime. Mënyra se si është përpiluar raporti është marrë nga planifikimet vjetore veç i kanë bartur e i kanë bërë si të realizuara aty vërehet edhe nga fjalët në fjali “do të relizohen”, realisht do të duhet të ishte “është realizuar”. Ky është nënçmim i institucioneve dhe përgjegjësisë institucionale. Kjo po na kushton në moszhvillim të bujqësisë, na kushton në hudhjen e parave pa benifite më pastaj. Ne nuk duhet ta lëshojmë vetën e të themi që i kanë marrur motokultivatorët dhe u kry. Problemi është më shumë se kaq. A e dimë ne që se ku kemi arritur në sektorin e bujqësisë dhe nga dojmë për të shkuar?!

Ky raport nuk tregon se cilat objektiva janë realizuar, cilat aktivitete janë organizuar dhe cila është kostoja e të gjithë këtyre dhe në fund s’janë përmendur sfidat. Në bazë të kësaj janë në ajër duke punuar dhe nuk janë vendosur në tokë dhe të shohin se si është gjendja. Me gjithë këto para që janë dhënë bujqësia është shumë keq. Ku shkojnë mjetet e participimit? Sa është vlera e tyre për këta 6 muaj? Me cilin kriter vendoset shuma e participimit? Pse participimi vendoset për disa projekte e pse jo për disa të tjera?

Nebih Bibaj: Përshendetje për të gjithë! Raporti është i përgjysmëuar dhe bujqësia është më e madhe se sa raporti në tri fletë. Drejtor është mirë që më shumë të koncentroheni në ujitjen e tokave bujqësore me gjtë një mënyrë për ujtije, konscentrimi në infrastrukturën bujqësore se sa në motokultivatorë e sera. Drejtor, a i keni monitoruar shpërndarjen e motokultivatorëve dhe serave, nëse i keni monitoruar a keni gjetur ndonjë rast ku të është shitur goldoni? Nëse keni ndonjë rast cilat masa janë marrë ndaj tij?

Luan Kryeziu: Sa i përketë raportit 6-mujor të Drejtorisë së Bujqësisë mendoj që ai është i hartuar në pikat kyçe dhe i mbulojnë kërkesat e anëtarëve të Asamblesë lidhur me gjendjen që është tek kjo drejtori. Këtu janë përfshirë shumë projekte që ne duhet t'i mbështesim që janë realizuar sepse janë në interesin e qytetarëve.

Sa i përketë atyre shifrarave që u përmenden secili nga mund të gabojmë gjatë hartimit të raportit me anë të kopjuterit dhe mund t'na ik ndonjë shifër. Ky mundet të jetë një gabim teknik e jo të aludoni në përgatitjen e ulët profesionale sepse drejtori është magjistër i shkencave në kuadër të kësaj fushe. Ne nuk kemi kompetenca që ta gjykojmë përgatitjen profesionale sepse janë ata personat uneversitar që e kanë vlerësuar. Është mirë që këtu të mos përdorim shprehje fyese. Ne grupi ynë e mbështesim këtë raport.

Kastriot Berisha: Luan, shko dhe tregoi ndonjë fëmije se si është ky raport. Ne nuk e kemi vlerësuar diplomën e tij, ne po e vlerësojmë raportin dhe punën e tij. Ne aty kemi gjetur shumë mangësi dhe po i paraqesim ato para jush. Ky raport është për mjerim. Mos e mbronin të keqen!

Hidajete Mazreku: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Ky raport i Drejtorisë së Bujqësisë është gjysmak. Arsyeja është se sektori i bujqësisë ka një rëndësi shumë të madhe duhet të krijohen biznese, të hapen vende të reja të punës dhe zbutet papunësia.

Drejtor, më vjen keq, mirëpo planifikimet disi nuk janë si duhet. Po nisem nga projekti i parë subvencionimi i fermerëve. A keni të dhëna se sa fermerë janë dhe sa kanë përfituar, sa prej tyre janë femra? Ne nuk i kemi listat dhe nuk po e dimë.

Sa i përketë subvencionve të bashkëfinancimit 70 me 30, në raportin e të hyrave e kam kërkuar këtë. Të hyrat nuk janë të raportuara.

Para se të ndahen subvencionet duhet të vihen kushtet dhe kriteret që qytetari të dijë se a i plotëson ato kriteret para se të aplikojë. Unë nuk kam parë se në bazë të kushteve dhe kriterëve është subvencionuar ndokush. Ne nuk kemi lista. Ne me Zyrën për Barazi Gjinore kemi qenë te Gentiana fermere në Plloricë. Kjo grua me familje është për t'u përshëndetur për punën që po bënin. Prandaj po kërkoj që ata që marrin definoni në bazë të gjinisë.

Ne në treg të Malishevës nuk kemi prodhime tona.

Te projekti i dytë, përkrahja e fermerëve me makina mjelëse dëshiroj që të marrin fermerët që kanë lopë e jo të merr çdo kush.

Te projekti i tretë me përkrahjen me motokultivatorë përfituesit duhet të kenë tokë. Aty ka aplikuar edhe nga komuniteti Arturi por ai nuk ka përfituar edhe pse ka tokë. Ai në këtë rast e sheh vetën si i diskriminuar.

Edhe të bletaria duhet të specifikohet gjinia se ka shumë femra që merren me këtë veprimtari.

Sylë Dukolli: Malisheva është vend rural dhe interesi ku mund të përfitojnë qytetarët sigurisht që është Drejtoria e Bujqësisë vetëm që duhet të kesh tokë dhe të aplikosh për subvencione. Sa shkojnë ato në vendin e duhur nuk e di, por po besoj që kanë shkuar aty ku duhet.

Kastriot, drejtori nuk është analfabet ka CV dhe ka të kryer fakultetin dhe masterin në Tiranë dhe më shumë i kam besuar Uversitetit të Tiranës se sa të tjerëve. Sa i përketë sa e din matematikën drejtori, ai me shifrën është gabim teknik dhe një gabim i tillë mund t'i ndodh gjithëkujt. Është mirë që mos të lëshohemi në gjëra të ulëta!

Projektet që janë në raport janë edhe të ekzekutivit të komunës, dhe drejtori i çon gjërat përpara. E di që raporti ka mund të jetë më me volum, por kanë mund të bashkëngjiten edhe listat e secilit projekt e kishte për të dal si libër leximi.

Sa i përketë planifikimit për vitin 2019 e kam parë që është shumë abicioz. Ejani të punojmë së bashku edhe komiteti e t'i vëmë gjërat në letër e së bashku të bëjmë më të mirën për sektorin e bujqësisë. Kërkoj që jo të rrisim zërin, por të rrisim punën.

Arlind Morina: Përshendetje për të gjithë! Drejtor të njoh mirë dhe ke marrë rekomandime të mira si nga opozita dhe pozita kur je bërë drejtor dhe shpresoj që në herën tjetër të hartosh një raport më të mirë. Të sugjeroj që përveç titujve që t'i përmendi Sylja të kryesh diçka edhe për automekanik sepse të duhet për t'i ndarë motokultivatorët. Është shqetësim nga ata që kanë aplikuar po i adresohem Astrazubit që janë dy qytetarë e që janë takuar edhe me Kryetarin. Sipas Kryetari që Kryesia e fshatit vendos se kush të merr motokultivator. Në fshatin Astrazub Kryesia e fshatit nuk është aktive. Është mirë që mos të lëjmë belë në fshat sepse aplikuesit duhet t'i drejtohen dikujt se pse nuk ka marrë motokultivator. Shpresoj që në vitet e ardhshme ata që janë meritore të përfitojnë.

Halil Morina: Sa i përketë këtij raporti që po e diskutojmë sot është normale që këto lloj subvencionimi e kanë një lloj ndikimi në ekonominë familjare sado që janë solid. Motokultivatori mundet që me ja lehtësu punën një fermeri, por s'mund të ketë efekt të rëndësishëm në bujqësi me anë të këtyre subvencioneve. Duhet shumë e më shumë mjete për të pasur një impakt të rëndësishëm në bujqësi.

Kërkoj nga Drejtoria e Bujqësisë që në të ardhmen të ndahen sa më shumë mjete jo vetëm subvencionim por edhe nxitje të llojeve të ndryshme për shfrytëzimin e kullosave për blegtori. Ky raport më shumë ka qenë informues se sa i detajuar. Nuk është që Muarti nuk di të bëjë një raport siç duhet, apo që nuk di se sa bëjnë 2 edhe 2, mirëpo mënyra se si ju keni drejtuar dhe e keni fyer e ka bërë që mos të bashkëpunojë me ju. Është mirë që të përpiqemi të përmirësojmë aty ku ka vend të përmirësojmë.

Pyjet po dëmtohen shumë nga prerja ilegale, a keni ndonjë roje të pyjeve? Prandaj është mirë të përqëndrohemi në tema të rëndësishme që të mos t'na shkatrohen pyejet, dhe të debatojmë për gjëra që na përkasin të gjithëve.

Rrahim Morina: Është mirë që të investohet për një investim të qëndrueshëm, aty ku krijohen vende pune si ferma, platacione etj. Hajde që të ndërtojmë një strategji se si ta ndihmojmë bujqësinë në K. e Malishevës.

Është gjynah që një raport ku një derjtori ka investim mbi 500,000.00€ e të bëhet me 3 faqe. Nëse janë darë të gjithë ato subvencione është dashur të jenë edhe kriteret e të përfshien në raport së bashku me listën e përfituesve.

Sipas autitorit thuhet që kriteret i kanë plotësuar 16 aplikues ndërsa kanë përfituar 10 nga ta motokultivator. Atëherë pse nuk kanë marrur 6 prej tyre nëse i kanë plotësuar kriteret?

Alban Mazreku: Drejtor, në listën që e keni publikuar aty ka edhe raste sociale që janë përfitues të subvencioneve. Nëse dikush që e ka të përfituar socialin ai nuk ka pronë të vetën. Atëherë ai me social të kriteret që ka Drejtoria e Bujqësisë për subvencion ai duhet të dëshmojë që ka pronë. Kjo po bie në kundërshtim njëra me tjetrën.

Murat Hoxha: Sa i përketë raportit që po thoni që është i mangët dhe te gabimi teknik që është bërë në raportin e parë, unë pasi e kam vërjetur këtë gabim ne e kemi përmirësuar dhe e kemi

dorëzuar raportin tjetër te Zyra e Kryesuesit me kohë. Nuk e di pse nuk është shpërndarë ai i sakti?! Ju kërkohet falje për këtë!

Vlerat në raportin e Bujqësisë janë sipas kontraktorëve ndërsa në raportin e Finacave paraqitet vlera shpenzuese.

Ka fermere femra që janë përfituese të subvencioneve, ju i keni listat ku janë ato përfituese dhe shoqatat e grave fermere të K. së Malishevës.

Është një komision i cili mbikëqyrë nëse ka keqpërdorime kontrat e përfituesëve me K. e Malishevës. Në kontratë ceket se nuk guxon të shitet motokultivatori në periudhë 3-vjeçare, përndryshe futet në listën e zezë.

Kërkesat për motokultivatorë kanë qenë mbi 700 kërkesa, por përfitues janë vetëm ata që i kanë plotësuar kërkesat.

Kastriot Berisha: Ne, Kryetari dhe drejtori i Bujqësisë duhet të jemi më transparentë. Ky raport është shumë i mangët. Drejtor t'i na dhe sot dy informacione të cilat kanë mundur të jenë të shënuara në raport. Drejtor, në raportin tjetër sjellna informacion dhe dëshmi për përfituesit dhe do të përkrahim kudo që ke nevojë.

Rrahim Morina: Materialin shtesë që e ka sjellë drejtori i keni nëpër tavolina në Kuvend. Ne i kemi rekomandimet e Komitetit për Bujqësi e që janë 5 rekomandime ju i keni para jush. Kush është pro këtyre rekomandimeve të Komitetit për Bujqësi për Drejtorinë e Bujqësisë?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim: 7

Me këtë votim aprovohen këto rekomandime për Drejtorinë e Bujqësisë nga Komiteti i Bujqësië. Atëherë shkojmë ne pushim të drekës shihemi pas një ore.

Pas pushimit të drekës vazhdojmë me mbledhjen dhe kalojmë në pikën e 5-të të rendit të ditës:

Shqyrtimi i raportit të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.

Fjalën e Arlind Morina përfaqësues i Komitetit të Arsimit.

Arlind Morina: Komiteti i Arsimit me dt: 28 gusht në mbledhjen e III-të ka ka shqyrtuar raportin e DKAE-së për përfundimin e vitit shkollor 2017-2018 dhe për përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollor 2018-2019. Në këtë raport janë të gjetura disa të dhëna që ne kemi menduar të t'i japim këtu si rekomandime për Drejtorinë e Arsimit. Raporti ka edhe përparsitë e veta dhe një pjesë e tij ishte e mirë. Disa të gjetura janë: pjesëmarrja në testin PISA, trajnimi i disa mësimitdhënësve për korrikulë etj. rekomandimet i keni të shënuara dhe nuk po lëshohem shumë. Drejtor, te tabela në faqe 3, figurojnë në vitin 2017 dhe 2018 1000 të punësuar, ndërsa në raport janë 1063, d.m.th 63 janë më shumë. Ne duhet të dimë se sa është numri i saktë? Sa është numri i drejtorëve dhe sa është numri si ushtrues detyre? Të specifikohen ku janë problemet apo vështirësitë e ndërtimit të shkollës së Buvavecit? Pse është e vetmja shkollë që ka probleme me Zyrën e Prokurimit? Të saktësohen shkollat ku veprojnë korporuesit e paqës në lëndën e gjuhës angleze. Të saktësohen me numra shkollat jo shumë shkolla, sa donacione, sa nxënës etj.

Raimonda Krasniqi: Përhëndetje për të gjithë ju të pranishëm! Raporti lë shumë për të dëshiruar, jo vetëm nga ana e shifrave konkrete, por edhe nga të dhënat më elementare për

arsimin në Malishevë. Prej parafillorëve deri në arsimin e mesëm të lartë gjithësej janë 36-37 javë mësimi për vitin shkollor 2018-2019. Ky është një raport me 14 faqe që përshkruan edhe gjendjen në përfundim të vitit shkollor 2017-2018 edhe përgatitjen për vitin shkollor 2018-2019. Nuk po guxojmë të kërkojmë material më shumë sepse menjëherë po na thoni që po dojmë libër. E dimë që libri bëhet në shtëpi botuese dhe i përgatitë tjetër kush. Neve na duhet material jo vetëm sasior por edhe cilësor për t'u njohur me të gjitha të dhënat në gjendjen aktuale në përfundimin e një viti shkollor dhe përgatitjet për fillimin e ardhshëm shkollor e të dimë se në cilën situatë jemi.

Në faqen 3, në rreshtin e 3-të, u realizuan shumë aktivitete edukativo-arsimore bëhet fjalë për vitin shkollor 2017-2018. Cilat janë këto aktivitete në mënyrë konkrete dhe të çfarë rëndësie janë ato?

Në rreshtin e 5-të, në komunën e tonë funksion një çerdhe për fëmijë, 36 shkolla fillore të mesme të ulëta dhe 3 shkolla të mesme të larta. A janë paralele të ndara shkolla e Stapanicës dhe Gullubovcit dhe në varësi të cilave shkolla janë?

Në paragrafin e 2-të, në çerdhe mbajten mësimin 70 fëmijë të grupmoshave deri në 6 vjeç. Sa grupmosha kanë qenë në çerdhe gjatë vitit shkollor që kaloi, psh: sa fëmijë kanë qenë deri në moshën 2 vjeçare, sa fëmijë kanë qenë 3-4 vjeçar e kështu me radhë? Si kanë funksionuar këto grupmosha në çerdhe? Sa fëmijë janë në përfshirë në secilën prej grupmoshave? Sa është numri i tyre? Pse në çerdhe kanë mbajtur mësim edhe fëmijët e moshës deri 6-vjeçe? Ne e dimë mirë që fëmijët 5-6 vjeçar me ligj të arsimit ata e vijnë në mësimin në shkolla ku objekti i tyre si parafillor është në varësi të shkollës fillore. Sa është numri i strafit të punojësve në çerdhe?

Në tabelën e shifrave ku flitet për numrin e mësimdhënësve në arsimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë thuhet që numri i mësimdhënësve ku përfshihen edhe edukatorët janë 63 që janë në arsimin parafillor. Po në faqen 4, ku bëhet paraqitja dhe përshkrimi i arsimit parafillor shtohet edhe fjala çerdhe dhe numri është 61. Tani, nëse në arsimin parafillor i kemi 63 edukatore për fëmijët 5-6 vjeçar, pse është shifra më e vogël kur përfshihet edhe çerdhja? Në faqen 4, përshkruhet buxheti i aprovuar për vitin 2017, arsimit parashkollor të punësuar 61, shifra e pagave dhe medijave është më e vogël se sa buxheti i aprovuar për 2018-tën edhe pse numri i punëtorëve është i njëjtë. Pse?

Në faqen 6, sa i përket infrastrukturës në vitin shkollor që e lamë pas nxënësit filluan në shkollën fillore të mesme të ulët "Ganimete Tërbeshi". Çka filluan mësimin apo...? Gjithashtu filluan ndërtimet në fshatin Llazicë, Bardh dhe Lladroc, bëhet fjalë që po ndërtohen objekte të reja apo anekse? Kjo nuk është e qartë, nuk është e specifikuar ku është ndërtuar objekt e ku është shtuar aneks. Edhe në raportin që drejtori e ka sjellur në qershor unë e kam bërë këtë kërkesë që të qartësohet mirë se a filluan ndërtimet për një objekt të ri shkollor, apo për ndërtimin e ndonjë aneksi apo shtese.

Në paragrafin e fundit, në faqen 6, në fushën e trajnimeve shumë mësimdhënës kanë ndjekur trajnimin për udhëheqje arsimore. Cilat kanë qenë kriteret për të ndjekur këtë trajnim dhe si janë paguar shpenzimet e atyre mësimdhënësve që ju i keni çuar për të ndjekur këtë trajnim? Më poshtë, në përpjekje për konsolidimin e arsimit gjithëpërfshirës DKAE-ja ka organizuar takime edhe me Këshillin e Prindërëve për konsoliduar zërin e prindërve në trajnim dhe takime me Këshillin për çështje me rëndësi në sistemin arsimor. Kush është zgjedhur kryetar për Këshillin e Prindërëve?

Në rreshtin e parafundit po në faqen 6, në bashkëpunim me Korpusin e Paqes ka mësimdhënës të cilët kanë mbajtur mësim shtesë për gjuhë angleze. Në cilat shkolla janë angazhuar këta

mësimdhënës që po mbështesin mësimdhënësit tanë për avancimin dhe për mësim shtesë të gjuhës angleze?

Në faqen 7, Drejtoria për Arsim dhe Edukim përmes Zyrës së Kryetarit ka përkrah furnizimin me mjete mësimore për disa nxënës me kushte të rënda sociale. Nxënësit e cilave shkolla janë ndihmuar finaciarisht, sa ka qenë shuma finaciare dhe a është bërë shkolla "Hasan Prishtina" pjesë e kësaj përkrahje?

Në faqen 8, në mes të kërkesave të shumta dhe veprimtarive që ka kryer DKAJ-ja për vitin shkollor 2017-2018 është edhe organizimi i aktiviteve në koordinim ndërinstitucional me MASHT-in për testin e arritshmërisë. Çfarë ka bërë DKAJ-ja në mënyrë që testi i arritshmërisë dhe testi i maturës të jetë në nivelin e duhur?

Tek tabela, shkollat pjesëmarrëse në testin PISA përmendën dy shkolla, ajo "Kajtaž Ramadani" dhe shkolla "Hilmi Hoti". Pse nxënësit e shkollës "Kajtaž Ramadani" kanë mbantur testin PISA në shkollën "17-Shkurti" në Banjë dhe nxënësit e shkollës "Hilmi Hoti" e kanë mbajtur testin PISA në shkollën "Naim Frashëri" në Banjë? Pse nuk e kanë mbajtur testin në objektet e tyre shkollore këta nxënës.

Në faqen 9, në tabelën e përfshirjes në trajnime të fushës kurrikulare Edukata Fizike dhe Sporti është 00 në fazën e 1, 2, 3, 4. Nuk ka pasur asnjë prej mësimdhënësve të Edukatës Fizike të cilët janë trajnuar për të punuar me kurrikulë. Pse këta mësimdhënës nuk janë përfshirë në këtë trajnim, a ka munguar stafi që do t'i përgatitë ata në mënyrë që të punojnë me kurrikulë dhe si punojnë mësimdhënësit e kësaj fushe me klasën e 6-të, dhe si do të punojnë për vitin 2018-2019 me klasën e 7-të?

Në faqen 10, përmendet shkolla "Hasan Prishtina" për përfitim të grandit. Çka do të përfitojë kjo shkollë nga ky grand, në cilat fusha do të shpërndahet grandit?

Në faqen 11, paraqiten të dhënat statistikore për testin e arritshmërisë i cili është mbajtur në maj të 2018-ës. Këtu shifrat janë të knaqëshme por, a është realisht cilësia në këtë nivel kaq të lartë sa paraqitet në raport? A i kanë arritur këto suksese me meritë nxënësit tanë? Jo, unë do të thosha jo! Si çdo vit nxënësit e klasës së IX-të edhe ata të arsimit të mesëm të lartë vrapojnë që t'i zgjidhin përgjigjet e testit nëpër korridore e ata që janë më të shkathët vrapojnë që përgjigjet t'jua tregojnë shokëve të tyre. A keni bërë diçka ju si drejtor i Arsimit që së paku suksesi i testit t'i afrohet sadopak njohurive reale dhe përgatitjeve të nxënësve gjatë shkollimit fillor prej klasës së VI-IX?

Në faqen 12, përgatije për vitin shkollor 2018-2019, i kemi me të dhëna diku 3 faqe për 1 vit shkollor që diku janë 37-38 javë mësimi përafërisht 180 orë. Tash, a po kërkohet sasi apo cilësi e gjykon secili vet.

A ka përgatije për këtë vit shkollor nga DKAJ-ja, me plotë përgjegjësi do të thosha që jo. Në ditën e parë në shkollën ku unë punojë nuk ke pasur ku të shkelësh nga papastëritia. Nuk ke mundur të bisedosh nga zhurma e punojësve që vrapornin të punoni diçka për të filluar mësimin, kurse ne ishim brenda në orë mësimi. Atëherë filluar të punonin, të rregulloni dhe të sistemonin diçka që kishe mbetur në mëshirë të fatit prej qershorit kur ka përfunduar mësimi. Ditar në shkollë nuk ka pasur deri në javën e dytë. 8 javë pushimi nuk ka qenë kohë e majftueshme për t'u përgatitur që tekstet të vinin për 1 shtator të shpërndaheshin për nxënës dhe me 3 shtator ne të fillonim mësimin. As tekstet nuk kanë ardhur deri në javën e dytë të mësimi. 40 orë mësimi janë mbajtur pa tekste, pa ditar.

Planprogram për kurrikulë nuk ka në shkolla as për klasën e VI-të, as të VII-të që ka filluar sivjet kurrikula përveç disa shkollave që kanë qenë model për kurrikulën. Tekstet e kurrikulës bërthamë edhe në qershor e kam thënë që nuk ka. Është vetëm 1 në shkollë e gjithësej janë 18

mësimdhënës në shkolla më të vogëla. Secili mësimdhënës duhet ta ketë tekstin dhe udhëzuesin pranë vetës në mënyrë që të përgatitet për orë mësimore.

Po në faqen 12, punojnë me kontratë mbi vepër 2 punëtorë. Cilët janë këta punëtorë? Çfarë ka bërë DKAE-ja për të zgjidhur çështje me këta punëtorë me kontratë mbi vepër?

Përkthehet edhe programi i avancuar me pedagogë në procesin e mësimdhënies, mësimnxënies. Ne kemi mungesë edhe të pedagogëve edhe të psikologëve, më sa pash këtu ata janë duke u përgatitur që t'i përshatën punës për ciklin e ulët gjë që u mundëson ligji. Ndërsa për psikologë nuk është përmendur. Është shqetësim që kemi përmendur vite më rradhë sepse kemi kërkuar që një psikolog të punojë së paku në 5 apo 6 shkolla e dim që është numri i vogël i nxënësve nëpër shkolla e të jetë 1 ditë në javë të secilën shkollë.

Në përgatitje për vitin shkollor janë edhe përfundimi i trajnimit për kurrikulë. A jeni në dijeni drejtor që ka disa mësimdhënës që e kanë kryer me sukses trajnimin për kurrikulë në periudhën prill-maj të viti 2017 por nuk kanë marrur certifikata?

Në faqen 13, shkolla në Bubavec shumë shpejt do të përfundojë e mund të fillojnë vitin e ri shkollor në objektin e ri. Pse nuk ka përfunduar kjo shkollë, cila është arsyeja?

Në paragrafin e fundit, rreshti i 4-ërt, përfundimi i aneksit të gjimnazit "Hamdi Berisha". Pse në gjimnazin "Hamdi Berisha" nuk është punuar gjatë pushimeve verore që shkolla të bëhej gati me 3 shtator? Megjithatë edhe pse kanë punuar aty, mësimi ka filluar me nga dy paralele mbrenda 1 klase, merreni me mend cilësia çfarë mund të jetë aty.

Në faqen 14, a ka siguri për nxënësit, ndërkohë që aty po punohet? Aty bihet me tonelata material për të punuar dhe nxënësit janë aty të pranishëm.

Tek përfundimi, Çertifikatë në fushën e cilësisë sipas programit aktual të autorizuar nga MASHT-i ka filluar trajnimi për kurrikulë. A do të përfshien mësimdhënësit e Edukatës Fizike në trajnimin për kurrikulë për deri sa në vitin e kaluar ata nuk kanë qenë pjesë e kurrikulës, tash a do të bëhen pjesë e saj?

Pse nuk po zbatohet autonomia financiare e shkollave? Ku është ngecja?

Tani me kurrikulë është futur edhe gjuha gjermane në shkollat fillore me nxënësit e klasës së VI-të. Çfarë ka bërë DKAE-ja për lëndën e gjuhës gjermane në shkollat fillore pasi që në vitin e kaluar mësimdhënës të pakualifikuar e kanë dhënë këtë lëndë vetëm që kanë qenë simpatizantët të NISMA ju kanë bërë edhe 1 orë shtesë?

Në konkursin për vende të lira pune në arsim ka shifra të pasakta mbi kreditë e shkollimit të kokuruesëve duke i shtuar dhe i ndryshuar ato për interesa të ulëta politike. A jeni në dijeni drejtor për këto?

A ju paguani autobusin nxënësve të gjimnazit që kanë gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale? Sa është numri i tyre dhe prej cilave fshatra janë?

Alban Krasniqi: Këto pyetje të shumta që i bëri Raimonda është mirë që drejtori të i sjellë në formë të shkruar sepse nuk premtim koha që këtu ë u përgjigjet të gjithave. Sipas raportit vazhdon të shihet arsimi ende më shumë vetëm si objekt se sa si një insitucion. Në aspektin e cilësisë edhe pse u përmendën disa trajnime edhe pse është bërë një ecje në atë drejtim megjithatë këtu është një mospërputhje në mes të synimeve që i ka Drejtoria e Arsimit nga cilësia edhe atë që e synon Kryetari Begaj që synon veç infrastrukturë që siguron vota. A ka nevojë për shkollë të re në Panorc, Gurbardh, Turjakë apo kudoqoftë? Nëse po, atëherë pse? Këtu na duhet përgjigje që e ka emrin cilësi, edukim dhe përparim. Në shkollën e Panorcit në vitin 2000 kanë mësuar 468 nxënës, ndërsa po në atë shkollë sot i ndjekin mësimet 339 nxënës. Shqetësimi ynë kryesor do të ishte se pse po na ikin nxënësit, pse ka ra niveli i numrit të

nxënësve? Ne duhet ta trajtojmë këtë çështje dhe ta ndihmojmë me çka do tjetër shkollën e Panorcit përveçse me tullë e beton. Ne duhet të bëjmë investime të mençura dhe afatgjata në arsim duke i zgjidhur problemet, ndihmojmë nxënësit në mësimnxënie, të trajnojmë personelin, të paisim shkollën me mjete mësimore e jo të ndërtojmë shkolla të reja kur nxënësit po i braktisin ato. Rënia e numrit të nxënësve është duke rënë në mënyrë drastike.

Shqetësuese nëpër shkolla jën edhe kushtet higjieniko-sanitare që janë janë në gjendje të mjerushme dhe shkollat nuk po mirëmbahen. E ndërsa në anën tjetër janë harxhuar të gjitha paratë për mirëmbajtje të shkollave. Në asnjë shkollë nuk ka material higjienik. E pse nuk ka? Përgjigjia juaj duhet të ishte masat që duhet të merren.

E parë një investim mduket në qershor më shumë 20,000€ në shkollën e Lladrocit edhe pse këndeje është duke u ndërtuar shkolla e re. A është ai investim në shkollën e re, apo ku ka shkuar ky investim?

Shqetësuese është Testi i Maturës. Në Qendrën e Kompetencës përqindja e kalueshmërisë është 28% , e ky realitet i përqindjes na mungon në këto dy shkollat tjera. Këtu e shohim që është korruptuar Testi i Maturës, në strukturat e shkollës për të ardhur në një gjendje artificiale ku kalueshmëri është 80%. As në Amerikë nuk është klueshmëria sa në gjimnaz kaq e lartë.

Duke parë numrin në rënie të nxënësve mendoj që Drejtoria e Arsimit, Kryetari Begaj dhe ne duhet të marrim një vendim për të rishikuar secilën shkollë veç e veç për sa i përketë stafit, madhësisë së shkollave sa i ofrojnë kushtet, paisjet që janë të nevojshme për mësim dhe në bazë të kësaj të merren vendime lëvizje të stafit, zvogëlim të stafit apo rritje të stafit varësisht se ku është e nevojshme. Ne duhet të ndreçim arsimin sepse është më i rëndësishëm se sa votat.

Sylë Dukolli: Alban, pjesën më të madhe nuk ke folur për raport por për buxhetin në të ardhën, për ndryshe ky raport është i kompletuar.

Jam për cilësi dhe kualitet dhe pasqyra që pash në rezultatet e Testit të Maturës ndoshta pasqyrën reale na jep PISA. Unë i gëzohem çdo rezultati që është i knaqëshmë. Kërkoj nga Drejtoria e Arsimit të dërgoj më shumë inspektorë nëpër orë mësimi që të ndikoj në cilësinë e arsimit.

Sa i përketë shkollës së Bubavecit kam qenë dhe kam vizituar dhe ka filluar të lëvizë me hapa të mëdhenjë që sa më shpejtë të lëshohet për mësim ajo shkollë. Numri i nxënësve në shkollën tonë nuk ka rënë dhe është po i njëjti por ka shkolla ku numri i nxënësve është duke rënë.

Te programi për avancimin e mësimdhënësve numri pjesëmarrës i mësimdhënësve ishte 170 mendoj që do ta pasurojnë programin e ri me kurrikulën e re.

Keq ëshë që mësimi nuk ka filluar me 1 shtator në gjimnazin “Hamdi Berisha” është dashur që shkolla të përgatitet më heret por ja tani jemi para një akti të kryer.

Ne duhet të jemi të gjithë argatë që të rritet kualiteti se sa infrastruktura.

Blerim Thaçi: Përshendetje për të gjithë! Falemnderit për diskutimet sepse na ndihmojnë në punën tonë.

Alban, është e vërtetë që kemi pasur raportin e Inspektoriatit për shkollën fillore “Ibrahim Mazreku”. Ne kemi reaguar dhe është renovuar shkolla në shumë mbi 16,000€. Gjendja aktuale është e mirë, mësimi është duke u mbajtur me të vetmin shqetësim se është numri i madh i nxënësve në një klasë. Drejtori aktual në atë shkollë është i njëjti ai që ka qenë para 5 vitesh, e nuk duhet të bëhet kjo politikë.

Arlind, te shifrat e të punësuarëve që përmende 1000 dhe 1060, duhet ta keni parasysh që numri fizik në arsim nuk përkon me numrin real sepse është me norma. Kjo i bjen që normat mund të

jenë 1000 por ne mund të kemi 1060 punonjës sepse ka mësimdhënës që nuk e kanë normën e plotë.

Aktualisht janë tre drejtorë si ushtrues detyre. Korpuesi i paqe ka 2-3 mësimdhënës dhe ju sjellë me shkrim se në cilat shkolla është saktë.

Raporti shpejtues për Komitetin e Arsimit me 14 faqe është tek ju, sepse unë e kam raportin plotësues me 24 faqe.

Raimonda, kemi shumë aktivitete një ndër to janë edhe ato sportive.

Deri tani i kemi pasur tri paralele të ndara të shkollës dy kanë qenë të shkollës “Kajtaç Ramadani” në Burim dhe Gullbovc dhe paralelja e ndarë në Llozicë shkolla e Vërmicës ka qenë paralele e saj deri tani është pavarësuar.

Me ligjin e Arsimit Parauniversitar edhe mosha e fëmijëve 5 vjeçar pa i mbushur 6 vjet e kanë të drejtën të jenë në çerdhe. Në çerdhe janë grupmoshat 0-3 vjeç dhe nga 3-5 vjeç. Në këtë vit nuk i kemi përfshirë moshat 5-vjeçare shkaku i mungesës së hapësirës dhe mundësisë së vazhdimit të shkollimit nëpër shkolla fillore. Ka kërkesa të shumta për çerdhe dhe kam kërkuar që të ndërtohet një çerdhe tjetër ose të adaptohet ndonjë objekt i vjetër siç është i shkollës në Banjë. Te rasti i ndërtimit të shkollës së Panorcit, Gurbardh dhe Dragobil nuk i kanë kushtet për zhvillim të mësimi të mirë, orientimi dhe hapësira në klasë është shumë e vogël. Ne jemi duke shkuar drejt asaj që mësimi të shkoj gjithëditor.

Komuna nuk ka organizuar trajnime për udhëheqje arsimore, por trajnimin e kanë mbajtur vullnetetarisht vetë por na kanë informuar se kush e ka ndjekur dhe e kishim për obligim që t’u njoftojmë edhe juve.

Sipas informacioneve që kam Kryetar i Këshillit të Prindërëve është zgjedhur Feim Hoxha nga Maralia.

Shumica e nxënësve që kanë pasur kërkesa për ndihmë për fletore, çanta është ndihmuar mbi bazën e kërkesave që janë bërë nga prindërit.

Është e vërtetë që tekstet shkollore për nxënës janë vonuar, por ky është çështje dhe obligim i Ministrisë, jo i yni. Kur tekstet janë ardh këtu ne i kemi përshpejtuar procedurat dhe i kemi shpërndarë. Edhe ditaret në javën e parë kanë ardhur, por edhe kjo është çështje e Ministrisë, kur t’na bien ata ne i shpërndajmë.

Testi PISA organizohet prej Ministrisë me Organizatën Europiane Ndërkombëtare ata i caktojnë vendet, ata i caktojnë nxënësit dhe me të gjitha ata merren.

Trajnimet për kurrikulë i organizon Ministria e Arsimit. Kam informacione që disa prej mësimdhënësve të Edukatës Fizike e kanë kryer këtë trajnim, mirëpo gjithëçka varet nga Ministria klasa e VI-të dhe e VII-të janë në procesin e kurrikulës.

Shkolla “Hasan Prishtina” është e vetmja shkollë që është fituese e grandit me aplikim dhe e kanë projektin.

Sa i përketë Testit të Maturës dallimi në mes të shkollës së Kompetencës dhe gjimnazit është i dukshëm edhe nga programet mësimore dhe drejtimet. Gjimnazi nxënësit i merr më të mirë dhe konkurrenca është më e madhe dhe përgjegjësia nuk është e DKAЕ-së por e Ministrisë dhe administruesëve që ka caktuar ajo.

Sa i përketë përgatijeve për vitin e ri shkollor i vetemi është aneksi i gjimnazit që është me vonesë e që nuk varet nga DKAЕ-ja por nga operatori. Sipas informacioneve që kam deri më 1 tetor aneksi lëshohet për punë mësimore, por do t’i zëvendsojmë me të shtunet ditët e humbura të mësimi. Me kontratë mbi vepër janë dy puntorë në DKAЕ. DKAЕ-ja duke më përfshirë edhe mua janë 5. Nëse krahasohemi me Suharekën ajo 12 i ka. Unë kam kërkuar nga Kryetari që ta kem një pedagog komunal që kishte për t’i inspektuar shkollat, dhe një inxhinier për disa

paramasa të thjeshta të shkollave, t'i kisha dy ekonomistë për çështjen e decentralizimit të buxhetit për shkolla jemi duke e shqyrtuar këtë mundësi por kemi probleme me shkolla të cilat kanë numër të vogël të nxënësve siç është Berisha.

Janë 60 pedagogë që mbajnë mësim sepse ju ka dhënë mundësinë Ministria.

Jam njohuri që një pjesë e mësimdhënësve nuk i kanë marrë certifikatat për trajnimin e kurrikulës po kjo është çështje e digasterit për trajnime në Ministrinë e Arsimit.

Ne kemi pasur konkurs për lëndën e gjuhës gjermane dhe për gjithë ato vende që kemi kërkuar e kemi pasur vetëm një të kualifikuar për këtë lëndë.

Transporti i nxënësve fillon më 1 tetor se është dashur t'i plotësojmë disa procedura dhe fshti Jançishtë dhe Garaqevë është duke u bërë ky transport.

Falemnderit të gjithëve për këto diskutime dhe pyetje gjithëçka që ju kam mbetur borgj pa u përgjigjur jam i gatshëm që t'ju përgjigjem edhe me shkrim edhe në ndonjë takim mes nesh.

Rrahim Morina: Pas diskutimit të kësaj pike ora është 16:00 unë jam që të vazhdoj mbledhja sepse e kemi pikën për buxhetin dhe për t'i plotësuar procedura është mirë që sot të bëhet leximi i parë dhe t'i japim hapësirë qeverisë komunale që t'i merr parasysh kërkesat e grupeve opozitare. Sipas disponimit të juaj po vazhdojmë mbledhjen para veç t'i bjëmë 5 min pauzë. Kalojmë në pikën e 6-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Projeket-Buxhetit për vitin 2019. Lus Kryetarin ose drejtorin që të paraqet buxhetin për vitin 2019.

Valon Mazreku: Përshendetje për të gjithë! Në bazë të Qarkores së dytë 2018 për procesin e hartimit të buxhetit për vitin 2019-2021 me theks të veçantë për vitin 2019 dhe pas të gjitha procedurave ligjore, pas 9 dëgjimeve publike ne i kemi nxjerrur dy forma të kërkesave. Kërkesat që janë adresuar nga kryetarët e fshatrave dhe kërkesat që kanë ardhur e që janë evidentuar në bazë të procesverbaleve që i kemi punuar gjatë dëgjimeve publike. Drejtoria për Buxhet dhe Financa e ka për detyrë hartimin dhe harmonizimin e kërkesave nga të gjitha komponentët e kyçur këtu që ta hramonizojë me kufitë dhe mundësitë buxhetore të cilat janë të përcaktuara nga Ministria e Financave. Atëherë buxheti për vitin 2019 totalisht i cili përbëhet nga 5 kategori ekonomike është në total 14,347,979.00€. Ky buxhet është i ndarë në 5 kategoritë ekonomike:

- paga dhe medijtje janë 8,812,895.00€, diku rreth 57% është një rritje prej 122,751.00€
- mallëra dhe shërbime janë 1,389,525.00€ diku 9% është një rritje prej 139,523.00€
- shpenzimet komunale janë 305,000.00€
- subevncione janë 105,000.00€ është një rritje prej 39,233.00€
- investimet kapitale janë 4,335,559,00€ ka një zvogëlimë prej 57,000.00€

në total krahasuar me vitin 2018 është një rritje e buxhetit rreth 245,000.00€

Në materialin që e keni të cilin ne e kemi përgatitur te pagat dhe medijtjet janë të ndara në bazë të programeve dhe nënprogrameve që i ka organizata buxhetore duke filluar nga administrata e përgjithëshme, shëndetësia dhe arsimit, arsimit parafillor, fillor dhe ai i mesëm.

Në mallëra dhe shërbime po ashtu janë të ndara në tri nënprograme administratë të përgjithëshme, shëndetësi dhe në arsim.

Shpenzimet komunale janë të ndara në në keto tri programe kryesore dhe subvencionet.

Kapitalet janë të ndara në nënprogramet si shëndetësia dhe arsimit që e kanë grandin e tyre specifik ku janë të pasqyruara të gjitha prej këtyre kategorive ekonomike se sa janë të ndara për arsimin dhe sa janë të ndara për shëndetësinë.

Ju i keni të pasqyruara në materialin që ju kemi dërguar dhe nuk po e trajtoj secilën në detaje veç e veç. Këtu i kemi intergruar edhe ndryshimet që i kemi pasqyruar edhe në Kornizën Afatmesme

Buxhetore ku është kërkuar ndryshimi i stafit nga Zyra e Administratës te Zyra e Kuvendit Komunal, pra tre zyrtarë bashkë me shkon edhe paga dhe kostoja e tyre dhe te mallëra dhe shërbime i kemi vendos 50,000.00€ ashtu siç ka qenë kërkesa dhe vendimi i Kuvendit. Ju ftoj që ju t'i adresoni të gjitha ato që i shihni si të arsyeshme dhe që kanë mundësi dhe hapësirë buxhetore të debatohen këtu dhe të merren parasysh.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Sylë Dukolli: Sa i përketë këtij buxheti, pothuajse nuk ka mbetur fshat që nuk është përfshirë qoftë në infrastrukturë qoftë në investime tjera dhe uroj që të realizohen të gjitha. Ne si grup i NISMA kemi edhe një kërkesë që në këtë projekt-buxhet të futet palestra sportive në fshatin Astrazub si dhe të shtohen, të shtohen rreth 2 km rrugë të asfaltuar në fshatin Carrallukë në lagjen "Balaj", "Krasniq" etj që përfshinë ajo rrugë si dhe 2 km trotuar në fshatin Carrallukë që përfshin lagjen e "Krasniqëve" "Balaj" etj te shkolla e re. Kërkoj nga të gjithë ju asambleistë pa dallime politike që të bëni kërkesa për investime e ta bëjmë një buxhet të mirë e gjithëpërfshirës për nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.

Alban Krasniqi: Në fakt ky është Buxheti i NISMA, pra propozimet e NISMA i kemi përpara. Unë i kam disa pyetje për drejtorin. S' di si t'i referohem me faqe Valon sepse s'ke lënë nr. të faqeve.

Ku shkruan koficienti a është dashur të jetë kodet apo çka?

Te auditori i mbrendshëm, faqja e parë, 2.0, është shfira 27,436.00€ stafi 2. Kjo shifër a është për një apo dy të punësuar?

Te faqja e 1, shpenzimet e udhëtimit mbrenda vendit janë 8,750.00€, çka nënkupton me shpenzimet e udhëtimit mbrenda vendit?

Te faqja 2, shërbime të telekomunimit dhe internet janë 5,100.00€. Ne kurrë spo kemi internet këtu, cilave shpenzime ju referohet kjo shumë dhe pse kjo shumë kaq e madhe?

Te shërbimet e arsimit dhe trajnimit. Pse kjo shumë është 117,669.00€ e futur te buxheti i komunës kur është buxheti i arsimit?

Çka është shërbime tjera kontraktuese ku janë 128,550.00€ duam sqarim për këtë? Te paisjet tjera, te blerja e mobileve më pak se 1,000€, pse janë 25,000.00€? Çka janë ato paisje tjera, çka e keni paraparë?

Në faqen 3, mirëmbajtja e ndërtesave, muzeut. Çka konkretisht keni paraparë për Muzeun e Dëshmorëve 11,000.00€?

Te suvencionet dhe transferet, pagesat për përfituesit individual është 105,000.00€. A është fjala në këtë rast për kërkesat që na bien qytetarët, për çka janë të dedikuara në praktikë?

Ku është i përfshirë vendimi i Kuvendit Komunal që t'ju ndahen lehonave për çdo lindje? Në cilën linjë janë të parapara këto mjete dhe pse nuk janë specifikuar?

Te projekt-buxheti për QKMF-në, tek mirëmbajtja. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve është 40,000.00€ tek QKMF-ja. Çka konkretisht keni paraparë kur e dimë se sa automjete ka aty?

Duam sqarime. Mirëmbajtja e ndërtesave është 11, 900.00€. Çka nënkupton kjo mirëmbajtje e ndërtesave të QKMF-së?

Shpenzime për vendime gjyqsore tek shëndetësia. Për çfarë vendime gjyqsore i keni paraparë 4,000.00€?

Ndërtimi i objektit të Emergjencës është planifikuar 100,000.00€. A është kjo shumë për të gjithë objektin, veç për vitin e ardhëshëm, apo është planifikim për këtë vit, mirëpo objekti mund të kushtoj më shumë?

Rrethoja e QKMF-së është 30,000.00€. Kjo është një shumë e madhe për atë mendoj. Pse është ky planifikim?

Paisje speciale mjeksore për spërkatjen e rriqërave janë 60,000.00€. për çfarë paisje është fjala dhe si ka për t'u menaxhuar këto paisje?

Paisje tjera medicinale janë 50,000.00€. Çka janë këto paisje tjera medicinale?

Ka një keqkalkulim te pjesa e arsimit. Mjetet e parapara jën 235, 725.00€, mua me ka dalur 236, 829.00€ edhe pse nuk është shumë e madhe tek disferenca.

Shërbime tjera kontraktuese, e këto tjera që janë 23,000.00€ cilat janë kto shërbimet tjera kontraktuese?

Furnizim me ushqim dhe pije janë 36,000.00€. Çka është paraparë me këtë shumë për këtë kategori?

Te shujtat për nxënës, cili është planifikimi për këtë vit, deri sa shkon buxheti që e keni ndarë, për vitin tjetër pjesa që e keni paraparë e mbulon deri në përfundim të viti? Sa është kostoja për një vit shkollor?

Hashim Vrenezi: Ne e kemi bërë një analizë të buxhetit dhe ky është një buxhet jotransparentë. Në këtë buxhet nuk kanë specifika zërat buxhetor dhe duhet të specifikohen në secilën kategori, në secilin lloj të shpenzimit të investimit të specifikohet edhe kodi ekonomik sepse jemi dëshmitarë që vitet e kaluara kapasur devijime të buxhetit nga një projekt në një projekt tjetër. Valon të sugjeroj që të marrësh si shembull buxhetin e Komunës së Ferizajit për vitin 2018. Ai ishte një buxhet që i plotëson kriteret dhe që i jep mundësinë një asambleisti që të mund të analizojë buxhetin dhe të vie deri te një konkluzion. Për të mund të bëjmë një krahasim me vitin 2017 ne është dashur ta kemi atë buxhet, buxhetin e 2018 dhe vitin që jemi duke e buxhetuar, ne këtë nuk e kemi.

Ju kur keni bërë shpalosje keni bërë shpalosje për pagat, aty ku nuk mund të manipuloni, por nuk keni bërë shpalosje tek pjesa e investimeve kapitale. Ne kemi nevojë për një buxhet të saktësuar, precizuar me kode ekonomike dhe të specifikuara me rrugë, lagje dhe gjithëçka çka dhe ku investohet.

Ne duhet të dimë tek bashkëfinacimi me qytetarët 65,000.00€ është veç një kod dhe ne nuk e dimë se çfarë lloje të bashkëfinancimit me qytetarët janë.

Ka shumë fshatra që kanalizimet janë blanko si Shkarashnik, 1000m, Carrallukë 1500m, Banjë 1000m, Drenoc 2000m etj. Nuk e dimë ne në cilat pjesë dhe a është duke shkuar në vendet e duhura a jo. Pak më e specifikuar është pjesa e ndriçimit publik se sa rtupa doni t'i çoni nëpër ato vende që i keni paraparë.

Tek planifikimi mjedisor dhe inspeksioni është ndërtimi i rrugës prej ures kryesore deri tek ura e minitransitit është e specifikuar në rregull, po këndej poshtë unë s'po e di se çka janë këto trotuare, rrugë apo çka?

Te shtrimi i rrugëve me kubëya përsëri nuk janë të specifikuara veç janë të përmenduar metrat dhe fshatipor jo edhe në cilën vend të fshatit. Njëjtë është edhe me asfaltimin e rrugëve.

Syla tha që buxhet është hartuar edhe nga kërkesat e kryetarëve të fshatrat. Ne të gjithë se si janë zgjedhur ata në mënyrën më banale dhe forma të ndryshme me asnjë kredibilitet në lagjen e vet. Ai është kryeplak i NISMA jo i fshatit.

Projektet që po bëhen nuk po mbikqyrën si duhet siç është rasti në fshatin Dragobil që dikujt para derës ju ka prishur rruga dhe dikush ka vë kubëza në formën e vet, atij nuk i prekën. Trotuari duhet të ketë vazhdimësinë e vet njëjtë para të gjithë dyerve të fshatit.

Avdi Morina: Më vjen keq që nuk kam qënë këtu nga fillimi i seancës por nga gjirmet jam me të vërtetë i shqetësuar me gjuhën e përdorur këtu nga disa kolegë! Ajo nuk gjuhë nuk është institucionale por e rrugëve dhe është mirë që të kërkonit flaje publike!

Malisheva është shembull i mirë se si përgatitet një projekt-buxhet. KDI dhe OSBE e disa organizata tjera e kanë marrë model buxhetin tonë. Unë e falemnderoj Kryetarin Begaj dhe drejtorin e Financave për gjithë atë aktivitet që kanë bërë nëpër terren dhe këtu për hartimin e buxhetit!

Në kuadër të investimeve që janë paraparë kërkoj që të rregullohet edhe një permendore në fshatin Burim në vendin ku është bërë Masakra e Burimit.

Halil Morina: Albani na u drejtu që ne jemi përfaqësues të NISMA, këta nuk janë NISMA, janë Kuvendi Komunal. Gjithaashtu the që ky është buxhet i NISMA dhe ju s'keni të drejtë të propozoni. Ky është buxhet i Komunës dhe asambleistët e NISMA kanë të drejtë të propozojnë dhe kërkojnë investime për buxhetin.

Ky buxhet ashtu siç është është ndërtuar në disa shtylla të cilat janë propozuar nga qytetarët, qofshin ata kryetarë të fshatrave qofshin organizata të ndryshme në dëgjimet publike. Kjo është para e qytetarëve dhe ata e dinë më mirë se ne se çka duhet të investohet në fshatrat e tyre. Mirëpo, mendoj që jemi vonuar pak në këtë çështje sepse si Kuvend është dashur të diskutojmë 1 muaj përpara që me pas kohë të analizojmë me detaje aty ku duhet dhe të gjitha rekomandimet dhe specifikimet që përmendet të harmonizohen në këtë buxhet.

Ju KPF- është dashur që kjo të jetë pika e 1-rë e rendit të ditës për sot sepse është më e rëndësishme se me diskutu për një raport të Bujqësisë që ne të kishim më shumë mundësi që t'i përmirësojmë disa gjëra.

Luan Kryeziu: Për Këtë buxhet e falemnderoj drejtorin që ka paraqitur një formë të mirë të projekt-buxhetit të përfshira fshatrat dhe specifikimet. Nëse diku nuk është specifikuar siç duhet kërkoj nga drejtori që t'i bëjë edhe ato specifikime.

Në projekt-buxhet mendoj që është një gabim teknik tek faqja 3 ose 4. Kam edhe disa propozime. Fshatrat që janë të vegjël është mirë që edhe ta të përfshihen në projekt-buxhet. Rruga "Minierat" në Goriq diku 600m është mirë që të futet në këtë buxhet sepse është kërkesë e fshatit. Për Pagarushën te ndriçimi e pashë është mirë që të specifikohet te rruga kryesore "Rruga e Refugjatëve" që lidhet me K.e Suharekës.

Hidajete Mazreku: Ky buxhet duhet patjetër që t'i plotësoj interesat dhe kërkesat e qytetarëve sepse ka një rëndësi të madhe për zhvillimin e K. së Malishevës. Ky buxhet nuk është i specifikuar në vende që duhet të specifikohet si probleme të cilat do të planifikohen në të ardhmen. Psh: te kanalizimet janë cekur si 1000m në Kjeve. Në Komitet për Komunitete e kemi diskutuar këtë dhe nuk është i caktuar vendi se ku to të bëhet ndërtimi i kanalizimit. Pra specifikimet do të ishin të domosdoshme për ne.

Sa i përketë planifikimeve në bujqësi. E dini mirë që në vitin 2017 dhe 2018 nuk ka prodhuar zhvillim ky sektor dhe nuk është krijuar asnjë biznes i ri. Pse ky buxhet kaq i madh deri në 400,000.00€ prap të jetë i njëjtë? Do të ishte më mirë që të planifikohet diçka tjetër me këtë

shumë jo veç në ndarjen e serave dhe motokultivatorëve, pra bujqësia të zhvillohet dhe të krijohen vende të reja të punës.

Në lagjen time ne nuk kemi kanalizim dhe impiantin e kemi në oborr, tani këtu në projekt ishte që rruga "Brezovica" do të shtrohet me kubëza është nën shtëpinë time dhe paraprakisht është dashur të jetë kanalizimi. Shumë herë e kam ngritur problematikën e derdhjeve të kanalizimit në lumin "Mirusha" e që po ndoet çdo ditë.

Sa i përketë ndriçimit publik, a janë me poçe elektrike a jën të kompletuara këto trupa sepse veç u përmenden kaq trupa këtu e kaq atje. Nuk po përshiheshin lagjet e komuniteve dhe ata po ankohen që janë të diskriminuar.

Është ndarë një shumë e madhe për planifikimin hapësinor dhe mjedisor që ishte 1,075,000.00€. Çka keni paraparë në këtë planifikim, si do të vie deri te mosndotja e ambientit?

Cila është godina e vjetër për hapjen e çerdhës? Ku është sepse këtu nuk specifikohet?

Tek shëndetësia është e ndarë shuma 130.000.00€ për vizitat me regjim shtrati. Çfarë punë kryhet me këtë dhe kush janë teknikët që i vizitojnë të smurët me regjim shtrati?

Ali Morina: Përshëndetje për të gjithë! Shqetësimi im për buxhetin e viti 2019 është te pika për ndërtimin e banimit social. Të gjithë e dimë se sa ngutja dhe presioni është bërë që të votjmë projektin për banimin social se mos të humbet investimi që vjen prej qeverisë e tani buxheti komunal ndanë 100,000.00€ për tu ndërtuar ndërtesa për banimin social. Drejtor kërkoj sqarim për këtë, pse është ndarë kjo shumë për ndërtimin e objektit për banim social?

Te shpenzimet e përfaqësimit është vlera prej 16,200.00€. Çfarë përfaqsimi, kë për ta përfaqësuar, kush?

Kur është votuar buxheti për vitin 2018 është paraparë shtrimi i rrugës për Nishor 1000m. Ndërsa përsëri për buxhetin e vitit 2019 e kemi të njëjtën rrugë diku 700m. Dua sqarim për këtë.

Alban Krasniqi: Pjesa e mos definimit të rrugëve, të lagjeve është edhe në shpalljen e tenderave dhe nuk dihet se ku shkon dhe si shkon. Ne në Carrallukë e kemi vujtur këtë fenomen sepse rruga e planifikuar diku tjetër ka shkuar diku tjetër. Kjo dukuri duhet të ndalet vetum duke u specifikuar në buxhet e në shpalljen e tenderave se ku ka me u shtu rruga dhe sa metra. Në cilin zë buxhetor janë të përfshira ndërtimi i shtëpive për rastet në nevojë dhe sa janë të planifikuara?

Ku i keni përfshirë shërbimet e varrimit dhe në cilin zë buxhetor? Ne e kemi një marrëveshje por në buxhet nuk janë të specifikuara.

Te mbështjettja e OJQ të ndryshme, ku i keni paraparë, në cilën kategori dhe cila është shuma?

Valon Krasniqi: U diskutua shumë për buxhetin e vitit 2019-2021 dhe me disa mendime të tyre pajtohëm dhe me disa jo. Konsultimi është bërë me konsultimin e kryetarëve të fshatrave por ata kryetarë janë përfaqësues të nëndegës së NISMA nëpër fshatra. Ky ndoshta edhe nuk mund të quhet edhe si projekt-buxhet i ekzekutivit por mund të quhet si buxhet i të fortëve në NISMA, sepse ka fshatra që janë diskriminuar në mënyrë flagrante si fshatrat malore. Është turp të flasim këru për ndriçimin në disa fshatra kur ka shkolla në fshatra malore nuk ka fare fusha sportive. Është koha që KF "Malisheva" t'i dalim zot sepse janë në një rrugëtim të mirë dhe është mirë të specifikohet një kod buxhetor dhe t'i ndahet ndonjë shumë këtij klubi.

Filloretë Bytyqi: Përshëndetje për të gjithë! Nuk them që është një buxhet i kompletuar dhe që s'ka vërejtje, por është një buxhet i mirë sepse pjesa ndërrmuese e fshatrave kanë përfituar diçka.

Unë kam kërkuar të përfshihen të gjitha fshatrat sepse të gjithë qytetarët e Malishevës participojnë këtu.

Të bëhemi bashkarisht që aty ku vërejtje ta përmirësojmë dhe t'ju japim përparësi prioritetve sepse projektet të gjitha do të shkojnë në K. e Malishevës. Do të doja që një palestër sportive të vinte në fshatin tim edhe pse është fshat i vogël por po arrijmë rezultate shumë të mira në sport. Sa i përket rrugës për Nishor po ju a jap një sqarim. Rruga për Nishor është tjetër, ndërsa rruga që lidh rrugën për Nishor dhe Malishevë është e lagjës "Kadriovitëve" dhe është 700m.

Hashim Vrenezi: Valon sa është çmimi mestatar për 1m kanalizimi, për 1m trotuari, rruge asfalti dhe për një trup ndërimi dhe cialt janë kriteret e tyre?

Ali Morina: Vazhdimisht drejtor e kemi ngritur shqetësimin për mirëmbajtjen e varrzave të dëshmorëve, por në buxhet nuk pashë asgjë sa i përket kësaj. Kërkoj që përveç mirëmbajtjes së varrezave, të parashihet diçka edhe për mirëmbajtjen e labidarëve sepse gjendja e tyre është e mjerueshme.

Alban Mazreku: Dua një sqarim edhe nga Kryetari edhe nga drejtori. Te planifikimi i buxhetinë vitin 2017 për vitin 2018 ishte edhe rruga nga ura e madhe në drejtim të urës së vogël atje të traziti të lidhet. Vlera e këtij projekti ishte rreth 400,000.00€ duke përfshirë edhe disa rrugë në lagjen "Veselaj", ndërsa të njëjtën rrugë e kemi edhe në buxhetin për vitin 2019 ku janë të planifikuara rreth 250,000.00€.

Rrahim Morina: Po flas si asambleistë dhe është mirë aty ku investohet sepse shkon në interesin e qytetarëve dhe jo vetëm ku janë sipantizanëtet e partisë, por gjithkund ku është e nevojshme. Është mirë që të specifikohen të gjitha projektet që mos të jetë mundësia e manipulimit me projekte. Nëse shkruhet vetëm fshati ju mundeni me çu ku të doni nesër. Në KPF, ju kemi drejtuar drejtorit dhe Kryetarit ku kemi kërkuar specifikacion të projekteve në bujqësi për vitin 2019, projektet për kanalizim, ujësjellës, trotuar për vitin 2018 që janë në ndërtim e sipër, në procesin e tenderimit dhe që janë votuar për vitin 2018. Kryetar, nuk është mirë të punohet me dy standarde, përderi sa në një fshat bëhet ndërimi vetëm në rrugën kryesore e ndërsa në lagje në disa fshatra.

Demir Bjara: Përshendetje për të gjithë! Unë në fillim kam menduar për këtë Kuvend ndryshe si dhe për këta delegatë këtë që janë të përzgjedhur nga populli. Kërkoj që në këtë Kuvend të mos fliten fjalë denigruese sepse nuk i mbëjnë nder askujt.

Mendoj që kjo pikë është voluminoze për Malishevën dhe është mirë të jemi konstruktiv dhe të japim kontributin e duhur dhe si pozitë dhe opozitë dhe t'ju mundësojmë investimet aty ku kanë nevojë qytetarët. Në fshatin Panorc dhe Rud kemi nevojë për investime siç është shkolla, trotuari etj. Edhe pse jam në NISMA kërkoj nga Kryetari dhe kompetentët që në buxhetin për vitin 2019 të futen disa metra asfalt për fshatin Panorc dhe Rud sepse është e nevojshme.

Raimonda Krasniqi: Edhe pse NISMA është në pushtet në Malishevë ne nuk mund të pranojmë të bëjnë politikë partiake me eufori këtu! Askush nuk mund t'na nëpërkëmb neve që kemi punuar që kaq kohë prej mbledhjes së KPF-së e kemi shqyrtuar me seriozitet dhe me punë projekt-buxhetin e përgatitur prej partisë së NISMA. Na lavdrohet ish-drejtori i Arsimit që qeveria do të bie miliona euro investime të shkruara në projekt-buxhet që i paguan komuna e që neve na

detyronte t'i votonim më qëllimin që mos t'i humbim këto investime ashtu siç është objekti i banimit social e ku komuna i ka planifikuar 100,000.00€. Andaj mos na hidhni sy neve dhe mos na shkel të gjithëve ish-drejtor.

Kërkoj që të specifikohet çdo projekt në cilat rrugë, lagje sa metra apo kilometra janë paraparë në këtë projekt-buxhet. Është e arsyeshme që përshkrimi i projektit të kanalizimit, asfaliti, të rrugëve me kubëza, dhe pom vjen mirë që ka ardhur luksi edhe ndriçimi. Tërpeza nuk ishte e përmendur tek ndriçimi qoftë edhe para përmendores dhe pjesë së shkollës pasi që është si qender e fshatit.

Në faqen 3 përshkruhen që në Malishevë 1500m, Gurbardhë, Shkarashnik, Tërpezë 700m prej shkollës drejt rrugës së varrezave. Çka është kjo? Çfarë lloj projekti është?

Ky nuk është projekt-buxheti i opozitës, të jeni të bindur! Ky është buxheti i NISMA! Tregon shumë qartë që për një familje çohet rruga, mirëpo ka lagje të tëra që nuk kanë asfalt, trotuar, ujësjellës apo projekte tjera që janë të domosdoshme.

Tek trotuari në Tërpezë kërkoj që trotuari të vazhdojë edhe me një gjatësi 700 apo 800m deri në lagjen "Lahaj" sepse nxënësit e tri lagjeve për të shkuar në shkollë duhet të kalojnë aty pari. Në lagjen "Lahaj" dhe "Hamzaj" janë disa familje që kanë nevojë për kanalizim për gjatësi prej 500m. Ato metra kanalizim që janë paraparë për Tërpezën sa do të ndahen për lagje dhe a do të ketë mundësi për dy lagjet që përmenda të ndahen 200-300m?

Tek ndërtimi i rrugës me kubëza betoni është përmendur Tërpeza 600m është lagjia "Lahaj" që i ka dy rrugë. Kjo ka qenë prioritet edhe në buxhetin e kaluar dhe pse nuk është realizuar kjo? Te Fashti i Ri, lagjia e "Nebihëve" do të doja të shtonim edhe lagjia "Mynishëve" 200m dhe "Islamaj" 500m asfalt sepse ka shumë banorë.

Tek blerjet shkolla "Labinot Krasniqi" në Mirushë është specifikuar blerja e inventarit, blerje printeri dhe paisje tjera. Por këto paisje që janë më poshte a nuk janë pjesë e inventarit të shkollës?

Shkolla "Visar Krasniqi", blerja e paisjeve informatike dhe paisjeve tjera. A është kabinet për nxënësit, a mësimdhës, mjete për informatikë për të punuar me kurrikulë apo çka?

Renovimi i gjimnazit "Hamdi Berisha", në vitin 2019 është 00. Në vitin 2020 janë 41,000.19€. A llogaritni që do ta renovoni atë objekt që ka qenë, aneksin që keni shtuar apo do të shtohet ndonjë pjesë tjetër?

Rrahim Morina: Pas debati, drejtori e ka fjalën.

Valon Mazreku: Thash që Drejtoria e Finacave është hartuese e buxhetit, jo planifikuese. Po janë edhe njësitë kërkuese të drejtorëve të drejtorive që i kanë bërë kërkesat dhe ne kemi bërë harmonizimin e kërkesave në raport me vijat buxhetore dhe kufitë buxhetor aq sa kemi pasur mundësi.

Alban, janë dy auditorë për komplet vitin fiskal 2019.

Te shpenzimet e udhëtimit mbrenda vendit është rasti i nxënësve që u paguhet transporti.

Te shpenzimet e arsimit dhe trajnimeve që janë specifikuar te buxheti i administratës së përgjithëshme përgjigjien do ta bie të premtën nëse ka mundësi. Një pjesë të përgjigjijeve mund t'ju a kthej me shkrim gjatë javës.

Tek shërbimet tjera kontraktuese janë të planifikuara që të mund t'i paguajmë edhe shpenzimet e varrimit afërsisht këto shërbime mund të jenë nga 40,000.00-50,000.00€ në vit. Këtu mund të jenë edhe kontrat qoftë për mallëra dhe shërbime që ne nuk mundemi t'i planifikojmë.

Tek paisjet tjera janë ato paisje që i duhen administratës së përgjithëshme komunale për të zhvilluar aktivitetet e veta që vlera e tyre është nën 1,000€.

Grandi specifik që është i ndarë për arsimin është i pamjaftueshëm për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet që i ka Drejtoria e Arsimit. Edhe te Investimet kapitale edhe te mallëra dhe Shpenzime ne kemi marrur prej grandit të përgjithëshëm dhe e kemi mbështetur arsimin. Tek mirëmbajtja e ndërtesave, është mirëmbajtje e objektit.

Tek subvencionet dhe transferet janë të destinuara te Zyra e Kryetarit, ndihmat individuale në raste të nevojshme diku rreth 20,000€, te arsimi janë të planifikuara për bursa nga të hyrat vetanake afërsisht 50,000€ dhe pjesa tjetër është për Drejtorinë e Kulturës, për OJQ shuma është 40,000€ afërsisht.

Vendimin që 100€ të ndahen për lehonat nuk e kemi paraparë ndoshta është gabim i yni por do ata rregullojmë këtë duke i parë mundësitë buxhetore.

Tek kategoria e mallërave dhe shërbimeve ne i kemi zërat buxhetor, mirëpo si alokim i mjeteve bëhet vetëm në një kod prandaj nuk specifikohen në buxhet.

Te tabela 4.2 e investimeve kapitale kemi planifikuar në v. 2020 është renovimi i mullirit në banjë dhe kulla e Llapçevës dhe mund të jetë gabim teknik aty për reovime sportive.

Mirëmbajtja e ndërtesave, mund të jenë ndonjë prishje e ndonjë nyje sanitare, pastrimi dhe higjiena etj.

Ndërsa te rrethoja për QKMF, është gabim sepse kërkesa është për rrethojat për QMF-të e që janë 30,000.00€.

Për vitin e ardhshëm janë ndarë 100,000.00€ ndërsa për vitin 2020 pjesën tjetër për ndërtimin e Emergjencës.

Ali, qendra për banimin social është projekt i qeverisë në bashkëfinacim nga një pjesë me Komunën e Malsihevës. Ne e kemi rritur vlerën e projektit për 40 familje dhe kjo pjesa shtesë që është bërë është planifikuar që të bëhet në vitin 2019. Diku afërsisht janë 600,000€ të Ministrisë dhe për pjesën që e kemi rritur është kjo shuma këtu.

Hashim, nuk e kam parë buxhetin e Komunës së Ferizajit dhe për shkak të çështjes kohore nuk e di a mundemi ta aplikojmë atë model, por do ta analizoj atë buxhet.

Sa i përket krahasimit të buxhetit të vitit 2017, këtij 2018 dhe këtë që e porpозojmë sot për 2019 besoj që mund ta integrojmë në këtë çështje. Sa i përket çështjeve te arsimit përgjigjet drejtori i Arsimit.

Blerim Thaçi: Alban janë futur në një kategori edhe pse Banka Botërore për lëndët shkollare ka ndarë rreth 90,000€ që janë 9 shkolla përfituese të grandeve shkollore dhe për shkak të procedurave që i kanë zhvilluar të tenderimit në mes të komunës dhe Bankës Botërore janë zvarritur dhe nuk janë realizuar dhe është kërkuar që të barten në buxhet të vitit 2019. Në këtë kuadër kemi edhe trajnime që janë si shërbime ndërsa mallëra janë teknologjia etj. Sa i përket shujtave sipse kontratës që është nënshkruar para 2-3 dite shpenzimet për këtë gjysmëvjetor janë 69,000.00€ dhe kërkoj nga ju që nëse bëni planifikim për shujtat për vitin 2019 të sillet shuma rreth 150,000.00€ sepse gjysmëvjetori i dytë është më i gjatë. Kërkoj nga ju që t'ua mbështetni një planifikim për 6-7 mars t'i dërgoj veteranët e arsimit pensionistë në Korçë. Kjo mund të hyjë në kategorinë e mallërave dhe shërbimeve ose te shpezimet e udhëtimve jashtë vendi.

Liridon Hoti: Alban, shuma 30,000.00€ është planifikuar për QMF në Kjeve që ka nevojë për parking dhe rrethoj të re dhe disa të tjera që janë të vjetëruara dhe kanë nevojë renovime dhe pletësime të ndryshme.

Blerim Thaçi: Shërnimet tjera kontraktuese janë në vlerë nën 1,000€ si është rasti të sanimet e ndryshme, të kanlizimeve ose edhe ndonjë shërbim tjetër që kërkohet. Ato janë si planifikim që mund të ndodhë.

Rrahim Morina: Drejtorët po thojnë që të premtën ju përgjigjemi për të gjitha ato pyetje që nuk keni marrur përgjigje.

Kryetar, për ato 3 pagat përcjellëse të punëtorëve të arsimit, shëndetësisë dhe të administratës unë kam marrur një shkresë nga MAPL-ja që thotë që: vendimi i Kuvendit Komunal mund të prodhojë efekte juridike. Deri ku ka mërr ky vendim dhe pse nuk është zbatuar? Depertamenti ligjor ka thënë që ky vendim prodhon efekt juridik.

Kryetari-Ragip Begaj: Në këtë çështje e kemi adresuar të Ministrisë e Financave, dhe ministria nuk e ka lejuar implementimin. Kam kërkuar një takim me ministrin dhe po pres përgjigje. Është mirë që ne për të gjitha komunat e kanë këtë problem, po buxhet për këtë nuk na është ndarë. Është mirë që ne për vitin e ardhshëm të parashohim një buxhet për këtë kategori për pensionistët dhe pagat jubilarë. Të gjitha diskutimet janë të frytshme dhe të rëndësishme, këta formularë të buxheteve që bëhen nuk janë vetëm për komunën tonë por janë unik për të gjitha komunat tjera. Ne mund të bëjmë edhe ndryshime duke e pasur këtë shumë të buxhetit që kemi. Të mallërat dhe shërbimet jemi të dëmtuar ne si komunë sepse ka komuna tjera që me banorë janë sa ne por shumën e buxhetit e kanë më të madhe. Ne nuk mundemi të dalim jashtë këtyre shumave që ka kufizuar ministria, por ne mund që mbrenda këtyre shumave mund të bëjmë cilën do zgjidhje. Sa i përket çështjes së shpenzimeve për rriqëra, auditorët na kanë dhënë vërejtje që ta regjistrojmë si aset të komunës. Ne nuk kemi mundësi që ta bëjmë këtë dhe na kanë dhënë mundësinë që përmes si paisjeve të bëjmë një tender për spërkatje të rriqërave. Të investimet kapitale ne i kemi mbajtur 9 dëgjime publike dhe aty ku kemi mangësi dhe cili fshat që ka nevojë për ndonjë investim mund të bëni kërkesa. Përparësi më shumë do t'ju jepja kanalizimeve prioritet sepse e ruajmë shëndetin, pastaj rrugët, pastaj gjërat tjera. Ky nuk është buxhet i NISMA por është i tërë qytetarëve sepse ku do që investojmë është për qytetarët tanë dhe prioritet kam dashur t'i jap në këtë buxhet Malishevës e sidomos në lagjen "Lagjia e Re". Urdhëroni kudo që ka nevojë në donjë fshat për investime paraqiteni kërkesat e juaja dhe çoni aty investimet sepse jam përkrahës i asaj që të mendojmë të gjithë njëjtë dhe kam dëshirë që buxheti i Komunës së Malishevës të votohet me të gjitha votat. Urdhëroni dhe harmonizoni gjërat ju grupet politike dhe ka është më e rëndësishme andej jepnjani kahjen. Kemi bisedime dhe takime që t'na ndihmojnë edhe në shëndetësi të objekti i Emergjencës. Është mirë që ne ta kemi një fond tonin që me pas mundësi që të bashkëfinancojmë. Kërkojë që të këtë buxhet ta harmonizojmë së bashku dhe të dalim mirë para qytetarëve.

Rrahim Morina: Ky është leximi i parë dhe a po pajtoheni që leximin e dytë ta lëjmë të premtën? Në rregull pra.

Është një pikë e rendit të ditës e 12-ta sippas rradhës për ndërrim destinim. A hedhim ne votim këtë pikë. Kush është pro shqyrtimit dhe miratimi i kërkesës nr.09/427 datë: 18.08.2018 të

parashtruar nga Osman Robaj nga fshati Astrazup për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore?

Për: 24

Kundër: 0

Abstenim: 1

Atëherë vazhdimi i mbledhjes bëhet të premtën dhe fillon në ora 10 me pikat e mbetura dhe në ora 13 të jetë mbledhja urgjente për leximin e dytë të buxhetit. Ju falemnderit për pjesëmarrjen, shihemi të premtën!

Pjesa e parë e mbledhjes përfundoi në ora 19:10

*

*

*

Vazhdimi i pjesës së dytë i mbledhjes së X-të të rregulltë të Kuvendit Komunal në Malishevë

Mbledhja mbahet me datë 28.09.2018 dhe filloi në ora 10:20. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 20 asambleistë, Nënkryetari, drejtorë komunalë, dhe media.

Rrahim Morina: Përshendetje për të gjithë! Jemi vazhdimin e mbledhjes së X-të të rregulltë për të trajtuar pikat e rendit të ditës që na kanë mbetur.

Sipas rradhës jemi te pika e 7-të e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa, dhe Gjoha Komunale për vitin 2019. E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Mazreku: Përshendetje për të gjithë! Kryesues, kërkoj që të nderohet me 1 min heshtje veteranin e UÇK-së Skender Krasniqin dhe njëherësh është prindi i asambleistit Alban Krasniqi!

Rrahim Morina: Atëherë ta nderojmë me 1 min heshtje punën dhe veprimtarinë e Skender Krasniqit!

Lavdi!

Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës.

Sylë Dukolli: Përshendetje për të gjithë! Më lejoni që të shpreh ngushëllimet në emrin tim dhe të grupit kolegut tonë! Baci Skend ka qenë burrë i mirë, mësues i mirë dhe luftëtar i mirë që i ka dhënë shumë vendit ai dhe familja e gjërë e tij.

Dua të lidhem me mbledhjen që patëm para dy ditësh dhe nuk e di a jemi asambleistët më të shquar në Kosovë, apo jemi ata që dimë të bëjmë detajizime pafundsisht por punët mjerisht nuk i kemi ashtu dhe jemi të fundit prej kumunave që nxjerrim udhëzime, kalojmë buxhete etj. jo për fajin e të gjithëve por për fajin e atyre që nuk e pranojnë realitetin. Këshilli i Sigurimit i përfundon mbledhjet për dy orë ndërsa ne s'po mundmi as për 15 orë me nga 2-3 ditë vazhdimësi. Me të vërtetë e kemi tepruar me këto mbledhje maratonike!

E kam lexuar këtë Rregullore dhe nuk kam se çka për të shkuar veçese për të gjitha gjobat, tarifat që duhet të paguhen për shërbime komunale nuk ka ndryshuar diçka ndër vite dhe ishte strikte. A ka mundësi të kemi si mostër edhe ndonjë komunë tjetër që të fusim nodnjë gjobë tjetër për bizneset dhe shërbimet që kryhen në Kuvendin Komunal.

Kudo që nxirret një certifikatë e lindjes e ka çmimin e njëjtë gjithëkund përveç disa komunave që kanë arritur një marrëveshje me Postën nëse do të nxjerrësh dokumente e paguan edhe transportin me Postë për në shtëpi.

Te bizneset e vogëla është tarfia fikse 25€ në përfshire të të gjitha atyre që paguajnë këtë ka pabarazi dhe sido që të jetë ne do t'i ngrehim këtu problemet dhe për t'i shtjelluar ato. Shembull: minimarketet dhe kjoskat paguajnë 25€, ndërsa kjoskat në fshat 0€. Pra nuk është fitmi si në minimarket si në kjoskë. Edhe Tregu i Automjeteve e ka të njëjtin çmim dhe jua e dini se sa është çmimi kur të hyni aty sa paguani.

Te hotelet dhe restorantët paguajnë 150€ për dallim të atyre sezonale e kemi 800€. Për mua kjo është e pajustificueshme.

Transporti i rregulltë i udhëtarëve me autobus dhe i kompanive të taksive tarifa është 35€. Ju e dini sa ka udhëtarë autobusi dhe sa ka taksi.

Alban Mazreku: Kjo Rregullore është që e kemi mirtatuar në muajin e 1-rë dhe nuk ka hyrë në zbatim asnjë ditë sepse është zbatuar Rregullorja e vitit të kaluar.

Ne si grup kemi disa kërkesa të rriten çmimet për kazinot dhe bastoret sportive. Ne mendojmë që taksat tjera të hiqen, vetëm t'i lëjmë këto tjerat që janë të dëmshme për shoqërinë përveq atyre që përmenda është Posta, KEDS, bankat mikrofinaciare etj. Në leximin e dytë ose në KPF ne mund t'i paraqesim kërkesat dhe regomanimet si grup politik.

Valon Krasniqi: Ne grupi i LDK-së i shprehim ngushëllime familjes Krasniqi për humbjen e veteranit të UÇK-së Skender Krasniqin!

Ne jemi që kjo Rregullore të shkojë njëherë në debat publik.

Luan Kryeziu: Përshendetje për të gjithë! Unë e përgëzoj punën e atyre që kanë përgatitur këtë Rregullore dhe mendoj që është e harmonizuar me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale me Satutin e Komunës dhe të gjitha ato rekomandime që janë dhënë nga Ministria e Financave dhe MAPL-së. Ne si grup e mbështesim këtë Rregullore dhe të shkojë në debat publik.

Hidajete Mazreku: Përshendetje për të gjithë! Së pari ju shprehi ngushëllime familjes Krasniqi, Komunës së Malishevës dhe të gjithë atyre që kanë njohur Skender Krasniqin! Ne për këtë Rregullore i kemi dhënë vërejtjet, sugjermiet dhe besoj që janë të specifikuara aty. Mendoj që kjo rregullore të shkojë në dëgjim publik e pas asaj ta miratojmë ne.

Dibran Kastrati: Përshendetje për të gjithë! Kam një kërkesë te neni 11 sa i përket Rregullores. Kemi persona përgjegjës të bizneseve afariste të cilët nuk i paguajnë taksën komunale, ne Drejtoria e Inspektoriatit ju bëjmë vërejtje me shkrim e procedojmë lëndën për gjykatë por nuk shqyrtohet. A është mundëshme që këtë çështje t'a çojmë tek përmbarusi privat? Te gjobat për mallërat me afat të skaduar ne i kemi 100€. Kërkoj që kjo gjobë të ngritet nga 300-500€ sepse ato mallëra janë të dëmshme për shëndetin. Kjo mund të ndryshohet te neni 12.

Kastriot Berisha: Përshendetje për të gjithë! Unë e përkrahi kërkesën e drejtorit të Inspektoriatit e të mos të presim gjykatën 3-4 vjet por të jetë një vendim i premë. Gjithashtu e përkrahi edhe kërkesën për rritjen e gjobës për mallëra të skaduara.

Valon Mazreku: Përshendetje për të gjithë! Për të njëjtin format të kësaj Rregullore ne e kemi marrur një vendim ku para se të merret ai vendim qeveria Begaj ka propozuar që të lirohen bizneset të cilat ushtrojnë veprimtari, por me vendim të Asamblesë kjo nuk ka kaluar dhe janë caktuar taksat ashtu siç janë të përcaktuara në këtë Rregullore. Kjo Rregullore ka shkuar në MAPL dhe ajo e ka dërguar në ministri të linjës ato kanë kthyer përgjigje që kjo Rregullore tashmë duhet të zbatohet por duhet të debatohet për vitin 2019.

Kjo Rregullore ka një dallim të madh me të gjitha komunat tjera është për taksat që keni vendosur ju te Administrata publike komunale për shërbimet. Aty është krijuar një laramani. Çertifikata e lindjes në Suharekë është më shtrejtë se sa me marrë në Malsihevë ose në gjitha komunat tjera. Si rezultat i joharmonizimit ndërmjet komunave Asosacioni i Komunave në bashkëpunim me gjithë drejtorët e Financave në nivel vendi kanë krijuar një grup punues që do të merret me hartimin e një rregullore unike për të gjitha komunat. Ky grup punues do të fillojë të punojë nga 1 tetori dhe vazhdon deri sa t'i përfundojë punimet.

Rrahim Morina: Mbase s'ka diskutime më e hedhi në votim. Kush është pro që Draft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa, dhe Gjoba Komunale për vitin 2019 të shkojë në debat publik? Për: unanimisht

Atëherë kalojmë në pikën e 8-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për Periudhën Janar-Shtator 2018. E ftoj drejtorin që të raportojë.

Valon Gashi: Përshendetje për të gjithë! Gjatë kësaj periudhe kjo drejtori bartëse e aktiviteve në menaxhimin e emergjencave në territorin e Malishevës gjithmonë duke menaxhuar në sektorët në varësi të detyrave dhe të punëve sipas Planit të Punës për vitin 2018 bazuar në ligje, udhëzime administrative dhe rregullore që janë në fuqi.

Të gjithë sektorët e kësaj drejtorie i kanë kryer puntë dhe detyrat me kohë. Gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka pasur situata emergjente dhe nuk ka pasur nevojë që të aktivizohet Komiteti Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim. Kjo periudhë është karakterizuar me vërshime, era të forta dhe stuhi në muajt janar-mars duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm në bujqësi, infrastrukturë dhe ekonomi. Gjatë të gjithë këtyre rasteve fatmirsisht nuk ka pasur humbje jete dhe as lëndime të rënda tek qytetarët.

Disa nga aktivitetet më të rëndësishme të kësaj drejtorie për këtë periudhë ishin:

- freskimi i planit të vlerësimit të rrezikut për territorin e K.së Malishevës
- freskimi i planit të reagimit të K. së Malishevës
- përgatitja dhe mbajtja e takmimve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
- vijimi i trajnimeve profesionale të personelit të njësitit të Zjarrëfikësve
- gaditshmëria dhe menaxhimi i personelit të Drejtorisë gjatë rasteve emergjente
- përgatitja, implementimi dhe monitorimi i projekteve për masat parandaluese ndaj Etheve Hemorragjike
- aktivizimi i njësitit për Mbrojtje dhe Shpëtim për sezonën verore
- vazhdimi i punës në hartimin e planit operativ emergjent për K. e Malishevës
- pjesëmarrja e personelit në komisionet komunale për vlerësimin e dëmeve

- pjesamarrja e personelit në menaxhimin e kontratave
- inspektimi i rasteve emergjente, hulumtimi i shkaktarëve të rrezikut etj

Drejtorja jonë është e ndarë në disa sektor:

- sektori për planifikimin emergjent
- sektori për informim dhe alarmim (në mungesë të personelit nuk është në funksion), por jemi munduar që t'i mbajmë kontaktet me të gjithë si në informim dhe alarmim
- sektori i preventives ndaj zjarrit
- njësi i zjarrëfikësve

Të gjithë këta sektorë kanë kryer detyrat sipas planifikimit dhe obligimeve të bazuara në ligj dhe rregullore në fuqi.

Sfidat: Ne si drejtori kemi hasur në disa sfida gjatë kryerjes dhe implementimit të planprogramit të punës për vitin 2018. Një ndër sfidat është mugesë e personelit, kemi mangu një zyrtar administrativ dhe ka mungesë të zjarrëfikësve dhe mugesë të fondit emergjent, statusi i pazgjidhur i zjarrëfikësve, mungesë e logjistikës etj. Falemnderit!

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Ali Morina: Sa i përketë këtij raporti unë kam dy pyetje. Te sektori i planifikimit emergjent është hartimi i një planprojekti, funksionalizimi i infrastrukturës, është instalimi i kamerave. Dua të di deri ku ka shku puna për vendosjen e kamerave është çështje që do t'i ndihmonte shumë sigurisë në komunën tonë?

Tek rastret e zjarrit në ushqim e bagëtisë janë 7 raste. A ka kompenzim nga komuna për qytetarët që kanë pësuar në këto raste dhe sa është vlera e tyre nëse ka ndodhur kompenzimi?

Nebih Bibaj: Drejtor, personat që i djegin arat pas korrje-shirjeve dhe si pasaoj e këtyre djegjeve kur janë afër malet po digjen edhe ato. A keni marrur ndonjë masë për ndonjë rast të tillë? Personat që po deridhin bërlllogun në mal dhe e djegin pastaj bërlllogun e pastaj po digjet mali. A i keni identifikuar këta persona dhe a keni marrur ndonjë masë ndaj tyre?

Luan Kryeziu: E falemnderoj drejtorin për një paraqitje kaq të mirë dhe për një prezantim të mirë të raportit! Raporti ishte në formën më të mirë që ju përgjigjet anëtarëve të Asamblesë. Ne si grup e mbështesim këtë raport të kësaj drejtorie.

Hidajete Mazreku: Ky raport në pika të shurtëra ka qenë i mirë, i caktuar, i definuar detaisht në përmbajtje.

Shqetësuese për mua është spërkatja e Etheve Hemorragjike sepse ka qenë pak. Fatmirësisht që nuk kemi pasur vdekje. Edhe pse nuk kemi pasur sivjet raste të rënda ne duhet që për vitin tjetër të përgatitemi për rriqërat. Dua që spërkatja të jetë në nivel dhe kur janë preventivat atëherë rreziqet janë më të vogëla.

E cekën edhe parafolesit që ka raste të shumta në vënien e zjarreve të mbeturinave. Rast të tillë kishte edhe mbrapa te Shtëpia e Shëndetit dhe ne i kemi disa fotografime. Këto zjarre ndotin ambientin dhe ndikojnë keq në shëndetin e njerëzve.

Ne gjatë kësaj periudhe kemi pasur edhe vërshime të ujit dhe familja ime ka qenë e mbyllur, me vonesë me disa kaminona zhavorë janë munduar ta kalojnë këtë situatë drejtorja juaj. Është mirë që ne të kemi një ekip për këso lloj emergjencash të përgatitur. Për vërshime uji, rrëshqije dheu, apo raste të zjarrit.

Hajdin Berisha: Përshendetje për të gjithë! Në emrin tim personal dhe në emrin e Komunës së Malishevës dua t'i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Krasniqi dhe gjithë bshkëlufëtarëve tanë për humbjen e madhe që sot kemi!

E falemnderoj drejtorin për raportin teje të detajuar që ka përgatitur dhe që e ka paraqitur këtu, gjithaashtu edhe për gjithë stafin për punën e palodhëshme që kanë bërë në shumë situata. Po ju kujtoj rastin e humbjes së një qytetari nga fshati Carravranë dhe e gjithë Drejtoria për Mbrojtje shë Shpëtim ka kryer një punë të sukseshme në realizimin e një plani operativ në mënyrë të detajuar.

Rasti i dytë është në Suharekë para disa kohësh ka pasur vërshime të jashtëzakonshme ne me zjarrëfikësit tanë ju kemi dal në ndihmë me profesionalizmin që kanë treguar aty janë falemnderuar edhe nga Kryetari i Komunës. Kjo neve na ka bërë të ndihemi mirë, të inkurajohemi që këtë drejtori ta pajsim me jete të nevojshme që tani për tani nuk i ka. Kjo drejtori spërkatjen e realizon në bazë të sugjerimeve që vinë nga QKMF-ja dhe aty ku paraqiten picikmet me numër më të madh aty bëhet edhe dezinfektimi selektiv në pamundësi të mbulimit të tërë sipërfaqes.

Raimonda Krasniqi: Drejtor, a keni ndërmarrë diçka me rastin e helmimit të peshqeve në lumin Mirusha?

Te projekti hartimi i planprojekteve, funksionalizimi, instalimi i vidokamerave në qytezën e Malishevës. Në cilën fazë është ky projekt?. Këtu kemi raste të shpeshta të vjedhës dhe policia është në aksion çdo herë.

Te faqja 4, sfidat, gjatë kësaj periudhe kemi pasur sfida gjatë implementimit të planprogrameve të punës për vitin 2018 e që janë mungesë personeli dhe mungesë të fondit emergjent. Unë mendoj që këto janë më shumë që janë nevoja se sa sfida.

Valon Gashi: Ali, unë së bashku me kolegun tim kemi punuar për 2 muaj për përgatitjen e projektit për instalimin e kamerave. Fatmirësisht Kryetari Begaj na ka përkrahur dhe ky projekt është në procedurat e prokurimit.

Për çdo lloj zjarri ekipi i zjarrëfikësve i bënë vlerësimet. Ne kemi Komisionin për Verifikimin e Vlerësimit të Dëmeve dhe Fatkeqësive Natyrore i cili del në terren dhe bënë vlerësimin e dëmeve dhe në bazë të asaj vlere ata i drejtohen për ndihmë Kuvendit Komunal. Sa ka fonde K. e Malishevës ju del në ndihmë, por mungesa e fondit emergjent si në nivel lokal edhe ashtu qendror po na sjellë vështirësi në kompenzimin e dëmeve. Në mungesë të fondeve nga këto 7 të djegjes së ushqimit të bagëtive nuk është kompenzuar asnjë.

Nëbih, problemin më të madhe ne e kemi me njerëzit e papërgjegjshëm sepse shkaktari kryesor i zjarreve është njeriu. Në çdo rast ku ne intervenojmë policinë e kemi me vete dhe me procedurat e dëshkimit merret policia.

Hidajete për spërkatjen e rriqërave përgjigjen e dha Nënkyetari unë mund t'i them përsëri gjërat e njëjta.

Njësitë i zjarrëfikësve intervenon në çdo rast kur lajmërohet nga policia, ne ose qytetarët. Rastin që ju përmendet sigurisht ata nuk kanë qenë të informuar.

Rajmonda, rasti i helmimit të peshqeve ka shkuar përmes Inspektoriatit dhe Agjensionit të Veterinës.

Fondi emergjent dhe mungesa e personelit për ne janë janë nevoja dhe sfida të mëdha.

Rrahim Morina: Sipas rradhës kalojmë në pikën e 9-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/333 datë: 10.09.2018 e parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës. E hapi debatin për këtë pikë.

Valon Krasniqi: Kjo është një temë majftë shqetësuese varrimi i veteranëve në varrezat e dëshmorëve. Në bazë të kërkesës që ka ardhur këtu janë cekur edhe rekomandimet që të gjendet diku një parcelë she të bëhet varrimi i veteranëve e jo të varrosen në Varrezat e Dëshmorëve në Kleçkë.

Në këtë rast e falemnderoj këtë Komitet që ka marrur guximin për të trajtuar dhe parandaluar këtë çështje sepse pas kësaj mund të ketë ndonjë person që ka fuqi indirekte në varrimin e veteranëve aty. Kërkoj që kjo kërkesë të miratohet dhe të bëhet rregull që tani e tuje të mos varrosen vetëtranët aty dhe nëse ne si Kuvend Komunal të ndajmë një parcelë për varrimin e veteranëve të luftës.

Kastriot Berisha: Më vjen mirë që Komiteti ka pasur guxim për të trajtuar këtë çështje që 20 vjet pas lufte ende varrosën veteranët në varrezat e dëshmorëve. Në çdo përvjetor që i përkujtojmë dhe i vizitojmë varrezat e dëshmorëve na vjen keq kur i shohemi të varrosur aty edhe ata që s'kanë rrënë në luftë pavarësisht kontributit që kanë dhënë ata. Këtë e dimë të gjithë që e ka bërë politika e mjerueshme dhe njerëzit që ne i njohim. Që dy mandate Kryetari dhe lideri i NISMA së bashku me udhëheqësit e partive tjera të PDK-së, VV-jes, LDK-së embi të gjitha ata që rrehin gjoks dhe thojnë që kemi qenë dikushi në luftë, d.m.th kanë e kanë jaran, mik e bëjnë dëshmorë për poena politikë. Kjo është e turpshme! Tani së fundmi kur ishte përvejetori në Kleçkë edhe ngjyrat i kishin dalluar të graniti disave me disa të tjerë. Aty ka njerëz që kanë vdekur para 40 vjetëve. Unë ju bëjë thirrje si familjeve e dëshmorit edhe familjeve tjera që ta ngrisin këtë çështje ja t'i heqim ne familjarët tanë e t'i varrosim aty ku i kemi varrosur mbas lufte, ja të ndërpritet kjo dukuri. Askush nuk është kundër veteranëve sepse janë vëllazrit tanë, pro kjo nuk është në rregull që të bëhen vetëtranë edhe ata që nuk ishin. Ju bëjë thirrje të gjithë atyre familjeve dhe personave që mos të binë pre e cilit do politikan.

Të nderuar asambleistë ju bëjë thirrje juve Nënkrjetarit, mbasi Kryetari nuk është le të kërkojnë prej organizatave të luftës, le t'i verifikojnë a janë të gjithë dëshmorë njëherë e përgjithmonë, sepse janë duke u rregulluar varrezat e dëshmorëve. Në atë ditë të tubimit dikush do të marrohet sepse prorurimi duhet të bëhet për dëshmorë se përndryshe ato nuk mund t'i quajmë si varreza të dëshmorëve nëse janë varrosur njëherë të vedekur mbas lufte.

Nënkrjetari e di rastin në fshatin tonë që dikush i thotë vetës veteranë e punon në Komunë e në realitet ai s'ka qenë në luftë dhe e gëzon të drejten sikur ai që ka qenë në luftë e akoma i ka copat e grantës në trup. Kjo është e turpshme! Kjo nuk ka për të shkuar gjatë dhe dikush do të përgjigjet për këtë. Ju bëjë thirrje të gjithë atyre familjeve se mos të binë viktimë e politikës si në rastin e tillë.

Sa pi i përketë ndarjes së parcelës që ka kërkuar për varrosjen e invalidëve të luftës dhe vetëtranëve për mua kjo çështje është e vonuar. Jo vetëm një vend për varrim por duhet të ndahet një pjesë ma e madhe për rekreacion për dëshmorë, invalidë dhe veteranë. Paramndo thojnë që 20 vjet mbas lufte nuk ka buxhet me i ndreq varrezat as në Kleçkë e as në Malishevë diku rreth 15,000-20,000€. A me këtë shumë një udhëtim e bëjnë diku veç për të shkuar për ndonjë drekë. A nuk është marre për ta?!

Kolegë asambleistë pres nga ju që të dilni këtu e ta diskutoni këtë çështje dhe t'ju tregoni liderëve të juaj pa marrë parasysh se cili është se kjo është gabim, dhe duhet të rregullohet kjo çështje.

Sylë Dukolli: Sipas kërkesës thuhet që të ndërpritet varrosja e veteranëve në varrezat e dëshmorëve në Kleçkë. Mendoj që organizatat e luftës është dashur që t'ju drejtohen me këtë kërkesë Prishtinës qendres kryesore e ata Qeverisë së Kosovës e kjo çështje të rregullohet prej së larti dhe nuk besoj që është adresë Kuvendi Komunal me nxjerrë eshtra sepse është përplasje. Ne ju kemi borxh deri në përulje të dëshmorëve të kombit, kemi obligim edhe për veteranët. Kastriot nuk e di kur ke qenë në Kleçkë, varrezat aty e kanë marrë një pamje të bukur. Nëse këto shoqiata që na u kanë drejtuar neve i përgëzoj nëse janë duke punuar në vijë të drejtë. Pajtohem plotësisht që dëshmorët duhet ta kenë vendin e veçantë ashtu si është bërë rivarrimi në fillim. Në Kleçkë jashtë rrethojës janë të varrosur 1-2 veteranë, e di që edhe atëherë kemi pasur përplasje. Nuk e di a është i zoti Kuvendi Komunal me i kry këto punë, nëse po unë dorën kam për t'ju dhënë, por janë disa gjëra që duhet të zgjedhën nga lart. Kjo kërkesë është e drejtë.

Kastriot Berisha: Sylë, ne nuk mundemi të presim a merr qeveria vendim a jo. Çdo qytetar që e ndjen vetën shqiptar duhet të japë kontributin e vetë për këtë çështje. A i heqin ata a jo, ata tq qeverisë le ta bajnë. Atyre nuk ju kovenon kjo çështje sepse dalin familajrët e tyre e ju thojnë që ti m'ke thanë.

Te varrezat e dëshmorë në Kleçkë nuk po na intereson a duket pamja e mirë a jo, neve si familajrë po na intereson eshtrat e dëshmorëve të pushojnë së bashku. Ne kemi shumë miq e jarana, a thua do t'i zë ai vend në Kleçkë të gjithë? Sylë aty ka jarana të liderit tënd. Nëse ata kanë qenë luftëtarë të çetës ne jemi përkrahës të juaj t'ju caktojmë një vend e ta dimë ku janë e kush kanë qenë. Pasatj të dalim te varrezat e veteranëve e ta dimë cilët janë ata, por jo me i bërë të gjithë bashkë.

Luan Kryeziu: Duke ju referuar kërkesës është e parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës kjo çështje është e ndjeshme dhe duhet të kemi kujdës që mos t'i qasemi në aspektin partiak. Falë gjakut të dëshmorëve, kontributit të invalidëve dhe të veteranë ne jemi sot këtu duke punuar dhe vepruar në liri. Ata janë të shenjtë dhe duhet t'i qasemi me një kujdes të shtuar. Te kompetencat në aspektin ligjor me sa e di unë Kleçka nuk është nën kompetencat e K. së Malishevës dhe se di sa mund të kemi fuqi atëherë.

Kategoria e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranë të vërtetë për mua është e shenjtë. Në qoftëse shkojmë tek ndarja e varrezave për veteranë të luftës e kemi edhe një problem tjetër çështja është edhe te gjyqësori se cili është veteranë i remë, e cili është i duhuri.

Këtu u përmend edhe lideri i NISMA, mendoj që ne jemi të vegjël të flasim për kontributin dhe punën e tij që e ka bërë gjatë luftës së UÇK-së dhe pas saj. Pavarsisht sfidave dhe proceseve gjyqësore që ka pasur çdo herë ka dalur i pastër.

Kastriot Berisha: Është e turpshme për ty nëse ti e mbronë të padrejtën! Fatmiri së pari kur është nisur për luftë armët i ka marrur tek ne ja ku i ke dëshmitarët Nënkryetarin dhe Sylën. Prindi im është vrrarë duke shkuar në pikë te Fatmiri, por kur është shkuar s'ka qenë. Këqyre dokumentarin, kuptoje. Kur ti e përkrah të keqen, vet je më i keq.

Për kohën e luftës çdo ushtari i përkulem, për kohën e mbasluftës kurrë mos e gëzofshin! Fatmir Limaj është ai që nga Drenasi i ka prurë në Kleçkë, përkulem për atë që ka qenë, por jo pse ky e ka pasur jaran.

Hidajete Mazreku: Kjo çështje që sot po trajtohet është shumë e ndjeshme përderi sa e dimë se sa kanë dhënë për këtë liri si dëshmor, veteran dhe si ushtar. Është manipuluar shumë me veteranët, emocionalisht ndjehem shumë keq sepse kush jemi ne që të votojmë për ta? Sa kanë kontribuar këta, ne jemi askushi për të debatuar për dëshmorët, veteranët. Kjo kërkesë është e Komitetit, do të dëshiroja në vlerësim dhe një raport të shoqiatave të dalura nga lufta në Malishevë. Ata do ta dinin më mirë këtë çështje sepse kanë qenë në vijën e luftës.

Alban Mazreku: Me të vërtetë kjo është temë e ndjeshme. Se sa është lehtë që të verifikohen veteranët e vërtetë dhe të pavërtetë është duke u nisur prej çdo komandati i cili i njeh ushtarët e vetë, atëherë le të merren masa ndaj atyre që nuk kanë qenë në luftë dhe i kanë njëllosur edhe veteranët e vërtetë.

Është e rëndë kur dëgjon që është varrosur një person në varrezat e dëshmorëve në Kleçkë ose në Malishevë dhe bëhet barabartë me atë me të vërtetë ka derdhur gjak për këtë vend, është e rëndë për shoqërinë tonë, për familjarët e dëshmorëve dhe për të gjithë ata që kanë qenë në luftë. Në fillim të kërkesës është bërë ndoshta një lëshim që e kanë cituar vetëm Kleçkën. Kisha kërkuar që te pjesa e kërkesës të shkohet edhe të ndalohej varrosja e veteranë në Kleçkë dhe në Malishevë. Kam një pyetje për drejtorin e Gjeodezisë dhe Kadastës. Pjesa ku janë të varrosur dëshmorët në Kleçkë a i takon komunës sonë?

Ne grupi ynë në parim e përkrahim këtë kërkesë nëse nuk ndërhyrë në ndonjë çështje juridike. Ndërsa sa i përket ndarjes së parcelës Komiteti duhet t'i drejtohet Kryetarit pastaj përmes tij të vijë në Asamble.

Sa i përket të varrosurëve më herët, është mirë që të bëhet verifikimi i tyre nga shoqatat e dalura nga lufat dhe nëse është e arsyeshme tërheqja e tyre duhet të tërhiqen sepse mos ta barazojmë atë që ka derdhur gjak me atë që nuk e ka bërë të njëjtën gjë.

Rrahim Morina: Me të vërtetë kjo është temë e ndjeshme por nuk është e padiskutueshme. Është mirë që të mos varroset askush në varrezat e dëshmorë sepse është e pandershme dhe joserioze që të krahasohet me dëshmorët, ose të bëhet dëshmor dikush që nuk është dëshmor. Është mirë që të klasifikohen këto gjëra.

Unë e kam thënë edhe për Masakrën e Burimit që aty kanë hy njerëz që në rrethana të ndryshme gjatë luftës. E di që edhe ajo është viktimë, por në të dallohet.

Sa i përket ndarjes së parcelës në kërkesë ajo duhet të vijë nga Kryetari.

Propozoj që të marrim një vendim që të ndërprehet vetëm varrimi i kategorive tjera si në Malishevë ashtu edhe në Kleçkë pastaj të japim hapësirë edhe për një debat tjetër, vlerësim të shoqiatave dhe për një iniciativë tjetër.

Ju lutem mos lëshohi në çështje politike dhe mos luani me dëshmorë sepse ata e kanë kryer misionin e vet duke dhënë gjakun për këtë tokë!

Luan Kryeziu: Kryesues është dashur t'ua japësh fjalën në momentin kur më është përmendur emri.

Kastriot, sa i përket fjalorit tëndë ndaj meje nuk do të replikojë me atë fjalorë sepse nuk është i kulturës sime.

Dëshmorët, invalidët, veteranët kanë luftuar që ne t'i respektojmë edhe institucionet e shtetit dhe të sillem si anëtarë të Asamblesë dhe ta respektojmë njëri-tjetër.

Kastriot, ne jemi një familje që i kem kontribuar luftës. Ndërsa Zëvendëskryeministri së bashku me disa nga dëshmorët ka qenë në vijat e para të luftës.

Kastriot Berisha: Luan, dy gjëra janë këtu ose duhet me pranë që ka bërë apo jo mirë që ka varrosur persona të komunave tjera në varrezat e dëshmorëve Zëvendëskryeministri juaj. Për kohën e lufës e thash që i përkulem çdo ushtari. Ti nuk mundesh të kesh dhembje më shumë se ne. Këtë e thash prej dhembjes.

Valon Krasniqi: Kryesues kërkoj që Kuvendi Komunal të mos ofendohet në shumës, por në njëjës! Mos të thuhet që jeni të vegjël, por të thuhet je i vogël!

Halil Morina: Përshendetje për të gjithë! Me të vërtetë kjo është një çështje e ndjeshme, mirëpo si një qytetari i këtij vendi është e arsyeshme që dëshmorët të kenë një vend special dhe askush të mos varrosët aty dhe veteranët duhet ta kenë një vend tjetër. Por unë kam disa dilema në mënyrën se si është bërë kjo kërkesë. Do ta jepja votën pro me plot kuptim në qoftëse kjo kërkesë do të kërkonte nga ne që të marrim një vendim që të kërkojmë nga institucionet qenderore që të mirrën me këtë çështje.

Po i referohem kërkesës, pjesës së fundit, paragrafit të parë që thotë kështu: kërkojmë prej Kuvendit Komunal që të nxjerrë një vendim për ndërprerjen e varrosjes së veteranëve të UÇK-së në varrezat e dëshmorëve të UÇK-së në Kleçkë si dhe të kërkoj nga familjarët e veteranëve të cilët janë varrosur në ato varreza që t'i nxjerrin trupat e tyre të pajetë. Nëse sot ne e marrim një vendim, kush e implementon këtë vendim?! Kush i merr bagerat dhe i nxjerr të vedekurit nga varrezat?! Kush e merrë përgjegjësinë?! Kjo është me shpall luftë në këtë vend. Pra kjo nuk është çështje që na përketë neve. Ne mund të rekomandojmë, të marrim një vendim që t'ju adresohet çështja në institucionet qendrore. Por me qenë ne implementues të këtij vendimi mendoj që është jashtë kompetencave tona dhe e apstenoj këtë çështje sepse i kam dilemat e mija.

Sylë Dukolli: Kërkojmë një pauzë të shkurtër që të konsultohemi në mes vete si grupe politike që të formojmë një fjalë për marrjen e vendimit.

Rrahim Morina: Atëherë po pajtoheni që të shkojmë në pauzë dhe të konsultohen shefat e grupeve sipas kërkesës së Sylës. Në rregull, shkojmë në pauzë.

Pas konsultimit të shefave të grupeve Albani e paraqet përfundimin e përbashkët.

Alban Mazreku: Ne pas konsultimeve me shefat e grupeve politike u dakorduam lidhur me kërkesën e Komitetit dhe shoqiatave të dalura nga lufta që në vendim të shkurtër kështu: të ndalohet varrosja e veteranëve në varrezat e dëshmorëve në fshatin Kleçkë dhe në Malishevë si dhe t'ju drejtohet nivelit qendror, shoqiatave të dalura nga lufta që me seriozitet të shqyrtojnë kërkesat e shoqiatave të dalura nga lufta të Malishevës si dhe kërkesën e familjarëve të dëshmorëve në komunën tonë.

Rrahim Morina: Albani e lexoj se çka do të shkruhet në vendim, atëherë kush pro që të merret ky vendim?

Për: 23 (unanimisht)

Me këtë votim unanim meret vendimi në fjalë.

Atëherë kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/334 datë: 10.09.2018 e parashtrua nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së si dhe Martirë të Luftës. Në bazë të kësaj kërkesë kërkohet që të lëshon 5 ari tokë nga komuna sipas procedurave ligjore. Por kjo kërkesë duhet të shkoj te Kryetari i Komunës pastaj ai t'a sjellë tek ne. Pra ligji kështu e thotë dhe nuk ka nevojë për debat. A pajtoheni që këtë kërkesë t'ja përcjellim Kryetarit? Kush është për?

Për: unanimit

Atëherë sipas rradhës jemi te pika e 11-të e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/322 datë: 30.08.2018 e parashtruar nga Mehmet Krasniqi nga fshati Tërpezë. Për këtë çështje po ju jap një informacion të detajuar sepse kam qenë anëtar i Komisionit për Emërtimin e Rrugëve. Këtu është bërë një lëshim atëherë kur është bërë emërtimi i rrugëve sepse janë dy dëshmorë me të njëjtin emër dhe mbiemër Afrim Krasniqi nga fshati Bardh dhe Afrim Krasniqi nga fshati Tërpezë. Kur janë shkuar të dy emrat në Agjensionin Kadastral të Kosovës nuk lejohen dy rrugë me të njëjtin emër mbranda komunës, prandaj ata rrugën e kanë emërtuar "Brkuseli" në vend të "Afrim Krasniqi". Ne e kemi pasur edhe një Komision për Shqyrtimin e Angesave për Emërtimin e Rrugëve dhe u patëm dakorduar edhe me prindin që rruga ta bajë emrin "Afrim Tërpeza", por ai komision nuk pati kaluar në Kuvend.

Ne sot duhet ta shqyrtojmë këtë kërkesë dhe të marrim një vendim dhe është mirë që emrin ta mbajë rruga "Afrim Mehmet Krasniqi". Kush është për ju lutem?

Për: unanimit

Atëherë kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës: Të ndryshme. Ne e kemi thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme për leximin e dytë dhe aprovimin e buxhetit. Unë kam thirrur edhe KPF-në, mirëpo kjo çështje është penguar nga Kryetari i Komunës nuk ka lejuar që të publikohen as thirrja e KPF-së dhe as thirrja e mbledhjes së Kuvendit. Ky është një veprim jo i hijeshëm sepse ka reflektuar drejtpërsëdrejti në punën e Kuvendit. Ne kemi biseduar dhe e di që opozita ka ofruar një buxhet alternativ dhe në sajë të paknaqësisë të kësaj ai vë pengesat që përmenda dhe të shpërndarjes së materialit gjithashtu edhe zyrtarët.

Mbledhja është e thirrur për ora 13, por VV-je në mungesë të Albanit dhe të Ilazit kanë kërkuar që ora e mbledhjes të shtyhet për më vonë. Për këtë kërkoj deklaratimet e shefave të grupeve në një pauzë për 5 min.

Pas konsultimeve me shefat e grupeve dua deklaratimet e tyre. Urdhëroni mund t'i paraqesni deklaratimet e juaja.

Sylë Dukolli: Ne jemi që mbledhja urgjente ashtu siç është thirrur të mbahet në ora 13.

Alban Mazreku: Ne u konsultuam në zyrën tuaj Kryesues dhe kërkojmë për hirë të respektit nga Albani dhe Ilazit sepse homazhet bëhen në Shtëpinë e Kulturës për vdekjen e babit të Albanit mbledhja të mbahet në ora 18.

Valon Krasniqi: Grupi ynë i LDK-së jemi që mbledhja të mbahet në ora 18.

Hidajete Mazreku: Ne jemi që të shtyhet mbledhja sepse janë homazhet për vdekjen e babit të Albanit, prandaj kërkuam që mbledhja të mbahet në ora 18.

Hajdin Berisha: Kryesues në cilësinë e Kryesuesit të Asamblesë do të duhej që ta heqje subjektivizmin nga vetja, kjo është e para! E dyta do të duhej që ta ndërtoni një raport korrekt të bashkëpunimit të drejtë

dhe në kohë të duhur me Kryetarin e Komunës. E treta, nuk do të duhej të flisje për Kryetarin këtu kur zyra e tij është e hapur në çdo kohë, jo vetëm oër ju por për të gjithë asambleistët tjerë.

Unë do të isha darkort sikur nga mëgjesi ta kishim shtyrë komplet mbledhjen dhe do të duhej që bashkarisht të shkonin për homazhe në familjen Krasniqi për ngushëllime. Kjo nuk është arsyeja pse kërkonin të shtyeni mbledhjen, çështja është krejt diku tjetër. Kjo që po të tentoni të bëni, kjo nuk është në rregull sepse variantet e juaja për një buxhet tjetër dhe në mënyrë klandestine ju shpërndatë asambleistëve, mbledhja thirret për lexim të dytë e materiali ju vjen për herë të parë. Në emër të grupit tonë është që të insistojmë sepse e drejtë ekskluzive propozimi i buxhetit nga Kryetari i Komunës. Këtë të drejtë Kryetari e ka të siguruar me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe të dokumenteve tjera bazike. Konsultoheni me ligjin sepse keni hy në një rrugë joligjore.

Rrahim Morina: Nën kryetar kam qenë disa herë te Kryetari dhe kam biseduar por është ai i cili e ka ndërprerë shpërndarjen e materialit. Kuvendi është ai i cili vendos për buxhet, jo Kryetari. Nëse kjo është në kundërshtim me ligjin janë institucionet më të larta që do ta vendosin është apo jo e drejtë. Janë dy propozime, propozimi i parë është që të vazhdojë seanca dhe ai i dyti të shtyhet seanca.

Hajdin Berisha: Ato që ju sapo thatë janë shndërruar në një retorikë të përditëshme dhe janë jofrytdhëse. Kërkoja që Kryesuesi i Asamblesë me Kryetarin të ndërtojnë raport korrekt sepse do të ishte më lehtë për të gjithë. Komplet po sillesh te arroganca e votave, te numrat. Kryesues do të duhej të dalësh prej vetës, të dalësh prej përfaqësimit të LDK-së këtu, je Kryesues i Asamblesë Komunale. Është diskutuar mbi 5 orë për projekt-buxhetin që ka sjellë Kryetari në Asamble. Jemi dëshmitarë të kësaj. Ku është verzioni i Kryetarit që disa ka asambleistët edhe kanë paraqitur kërkesat e veta? Është e drejtë ekskluzive e Kryetarit për të hartuar buxhet e asesi e Kuvendit. Detyrë e Asamblesë është të miratojnë buxhet pas shumë diskutimeve dhe propozimeve që bëhen.

Rrahim Morina: Kryetari është ai i cili nuk po bashkëpunon me ne. Çdo herë para se të bëjmë rendin e ditës konsultohem më të. Kryetari është ai i cili ka penguar Kuvendin. Kryetari e bjen buxhetin, Kuvendi e miraton, e diskuton dhe të gjitha mund t'i ndërrojë. Nëse kjo është në kundërshtim me ligjin, janë organet më të larta që do të merren me këtë.

Atëherë, kush është për që të vazhdojë mbledhja në ora 13, propozimi i Sylës?

Për: 10

Kundër: 14

Abstenim: 0

Atëherë mbledhja urgjente për miratimin e buxhetit komunal mbetet për ora 18 e që është propozim i tri grupeve politike PDK-së, LDK-së dhe VV-jes. Me këtë mbledhjen e X-të të rregulltë e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 12:40

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal: Rrahim Morina